

evropian

BOTA

në BE

BE-në:

SHPËRNDARJA E NARRATIVAVE DEZINFORMUESE KUNDËR NATO-S DHE BE-SË NGA AKTORË KUNDËRSHTARË NË MEDIAN SHQIPTARE

TIRANË, 2024

SHPËRNDARJA E NARRATIVAVE DEZINFORMUESE

KUNDËR NATO-S DHE BE-SË

NGA AKTORË KUNDËRSHTARË

NË MEDIAN SHQIPTARE



TIRANË, 2024

Publikuar nga:

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (BIRN Albania)

Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Albania

<http://birn.eu.com/>

Autorë:

Emiljano Kaziaj

Viola Keta

Redaktor:

Besar Likmeta

Përmbajtja:

Përshkrim i kontekstit 7

Shpërndarja e narrativave kundër NATO-s dhe BE-së 11

Metodologjia 15

Përzgjedhja e artikujve për monitorim 17

Fjalë kyçe të përdorura 17

Përmbledhje e gjetjeve kryesore 18

Gjetjet e monitorimit 20

Narrativat kundër NATO-s 22

Përfitimet e anëtarësimit në NATO: 36

Narrativat kundër BE-së 50

Angazhimi me narrativat kundër NATO-s dhe BE-së 74

—	Aktorët kundërshtarë	77	
—	Perspektiva e mediave mbi narrativat dezinformuese ndaj NATO-s dhe BE-së		89
—	Fluksi i lartë i lajmeve mbi NATO-n dhe BE-në	90	
—	Burimet e informacionit	91	
—	Mungesa e njohurive të specializuara mbi NATO-n dhe BE-në		92
—	Mungesa e politikave editoriale dhe korrigjimi i lajmeve të rreme		93
—	Kërcënimi nga narrativat dezinformuese	94	
—	Përhapja e narrativave dezinformuese	96	

Rekomandime 97

Përshkrim i kontekstit

Shqipëria është anëtare e NATO-s prej vitit 2009 dhe vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian që nga viti 2014. Si një vend që synon të forcojë pozicionin e tij në arenën ndërkombëtare dhe të kontribuojë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe global, Shqipëria i është bashkuar disa nismave ndërkombëtare, të udhëhequra nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në përgjigje të agresionit rus kundër Ukrainës.

Tirana zyrtare ka mbështetur sanksionet ndërkombëtare të vendosura nga SHBA-ja dhe BE-ja ndaj Ruisë pas aneksimit të Krimesë në vitin 2014 dhe agresionit në shkallë të plotë të Ruisë ndaj Ukrainës në vitin 2022. Duke u bashkuar me aleatët e saj të NATO-s dhe BE-së, Shqipëria ka miratuar sanksione ekonomike dhe financiare kundër individëve dhe entiteteve ruse, të cilat përfshijnë gjithashtu masa kundër përhapjes së informacioneve të rreme dhe manipulimit të opinionit publik nga aktorë të lidhur me qeverinë ruse. Këto sanksione vendosin një gamë të gjerë masash që synojnë të ushtrojnë presion mbi qeverinë ruse për të ndaluar agresionin dhe për të respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.

Sanksionet e miratuara nga Shqipëria ndaj Ruisë përfshijnë kufizime në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, ndalime në eksportin dhe importin e produkteve të caktuara, si dhe ndalimin e investimeve në sektorë specifikë të ekonomisë ruse, si dhe mbylljen e mediave të kontrolluara nga shteti rus, përfshirë ndalimin e transmetimit të kanaleve të lajmeve të kontrolluara nga shteti rus si “Russia Today” (RT) dhe Sputnik. Shqipëria ka marrë një seri masash për të zbatuar sanksionet kundër Ruisë në territorin e saj, duke përfshirë ngrirjen e asetëve dhe ndalimin e transaksioneve financiare me individë dhe entitete të sanksionuara.

Si anëtare e përkohshme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për periudhën 2022-2023, Shqipëria gjithashtu ka votuar rezolutat që dënojnë agresionin rus në Ukrainë dhe ka mbështetur masat që synojnë të mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Diplomatatë shqiptarë kanë luajtur rol aktiv në diskutimet dhe vendimet e Këshillit të Sigurimit, duke promovuar dialogun dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për zgjidhjen e krizave dhe për të adresuar kërcënimet globale të sigurisë.

Si anëtare e Këshillit të Sigurimit, Shqipëria promovoi dialogun e hapur dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve anëtare dhe jo-anëtare të Këshillit. Përmes ndërhyrjeve dhe propozimeve të saj, Tirana zyrtare nxiti përdorimin e diplomacisë parandaluese dhe mjeteve paqësore për të zgjidhur konfliktet. Për shembull, Shqipëria ka inkurajuar diskutime të thelluara mbi krizën në Ukrainë dhe ka mbështetur nismat me synim ndalimin e dhunës dhe arritjen e zgjidhjeve të qëndrueshme përmes negociatave.

Një nga prioritetet e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ka qenë dhe adresimi i kërcënimeve globale të sigurisë, përfshirë terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Shqipëria ka mbështetur rezolutat që synojnë forcimin e mekanizmave ndërkombëtarë për parandalimin dhe luftimin e këtyre kërcënimeve. Konkretisht, Shqipëria ka mbështetur rezoluta për sanksione kundër vendeve dhe individëve që mbështesin terrorizmin dhe përhapjen e armëve bërthamore.

Shqipëria ka theksuar rëndësinë e adresimit të krizave humanitare dhe të drejtave të njeriut në Këshillin e Sigurimit. Ajo ka mbështetur përpjekjet për të siguruar ndihmë humanitare në zonat e konfliktit dhe për të mbrojtur popullatat civile nga abuzimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Shqipëria ka qenë një zë i fuqishëm për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fëmijëve në zonat e konfliktit, duke kërkuar mbrojtje dhe mbështetje të veçantë për këto grupe vulnerabël.

Si një vend i Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ka përdorur pozicionin e saj në Këshillin e Sigurimit për të promovuar paqen dhe stabilitetin në rajon dhe ka mbështetur nismat që synojnë zgjidhjen e konflikteve ekzistuese në Ballkanin Perëndimor dhe ka inkurajuar bashkëpunimin rajonal si një mënyrë për të ndërtuar paqe dhe stabilitet.

Këto përpjekje të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit kanë dëshmuar angazhimin e saj për të kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin global, duke përdorur dialogun dhe bashkëpunimin ndërkombëtar si mjetet kryesore për zgjidhjen e konflikteve dhe adresimin e kërcënimeve globale të sigurisë.

Shqipëria ka shprehur mbështetjen e saj të plotë për Ukrainën në nivel diplomatik, duke dënuar publikisht agresionin

rus dhe duke kërkuar tërheqjen e trupave ruse nga territori ukrainas.¹

Shqipëria ka ofruar ndihmë humanitare dhe ushtarake për Ukrainën, ku përfshihen ndihma në pajisje mjekësore, ushqimore dhe materiale të tjera thelbësore, si dhe mbështetje për refugjatët ukrainas. Qeveria shqiptare ka rritur bashkëpunimin ushtarak me Ukrainën dhe me vendet e tjera të NATO-s për të forcuar mbrojtjen kolektive dhe për të adresuar kërcënimet e përbashkëta të sigurisë.²

Ky bashkëpunim përfshin trajnime të përbashkëta ushtarake, shkëmbimin e inteligjencës dhe mbështetjen logjistike. Një shembull konkret është pjesëmarrja e Shqipërisë në stërvitjet ushtarake të NATO-s, si “Defender Europe” dhe “Sea Breeze”, të cilat synojnë rritjen e gatishmërisë dhe kapaciteteve mbrojtëse të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s.

Shqipëria ka firmosur dhe ratifikuar një sërë marrëveshesh ndërkombëtare që synojnë përmirësimin e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive. Një ndër ato është Marrëveshja e Statusit të Forcave të NATO-s (SOFA), e cila rregullon praninë e trupave të NATO-s në territorin shqiptar dhe ofron një kornizë ligjore për operacionet e tyre. Gjithashtu, Shqipëria ka marrë pjesë në nismën “Partnership for Peace” dhe është anëtare aktive e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), e cila përfshin angazhime për sigurinë dhe zhvillimin ekonomik.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar disa rezoluta që adresojnë çështje të sigurisë dhe dezinformimit. Ndër këto rezoluta përmendim atë “Për ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike

¹ Ministria e Punëve të Jashtme. (2023). “Shqipëria dhe SHBA thërrasin takim në Këshillin e Sigurimit për të diskutuar ndikimin e agresionit rus tek gratë dhe fëmijët ukrainas”. <https://punetjashtme.gov.al/shqiperia-dhe-shba-therrasin-takim-ne-keshillin-e-sigurimit-per-te-diskutuar-ndikimin-e-agresionit-rus-tek-grate-dhe-femijet-ukrainas/>

² Përfaqësia e Përhershme e Republikës së Shqipërisë në NATO. (2022) “Ministrja Xhaçka prezanton sanksionet e Shqipërisë ndaj Rusisë: Gati të ofrojmë ndihma në materiale ushtarake dhe spitalore për Ukrainën”. <https://ambasadat.gov.al/otan/sq/ministrja-xha%C3%A7ka-prezanton-sanksionet-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-ndaj-rusis%C3%AB-gati-t%C3%AB-ofrojm%C3%AB-ndihma-n%C3%AB-materiale>

kombëtare”, miratuar më 5 dhjetor 2019.³

Një tjetër rezolutë është ajo e miratuar me konsensus të plotë në fillim të marsit 2022 nga Kuvendi i Shqipërisë “Për mbështetjen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës dhe mbrojtjen e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të sigurisë europiane”. Rezoluta dënon agresionin rus në Ukrainë dhe mbështet masat ndërkombëtare për të ndaluar agresionin dhe për të ndihmuar popullin ukrainas. Një tjetër rezolutë është ajo që kërkon bashkëpunimin më të ngushtë ndërmjet institucioneve shqiptare dhe ndërkombëtare për të luftuar dezinformimin dhe për të mbrojtur integritetin e informacionit publik.⁴

Sanksionet e BE-së - të miratuara gjithashtu nga Shqipëria- nuk shtrihen vetëm kundër mediave por edhe ndaj platformave online dhe rrjeteve sociale të lidhura me përhapjen e dezinformimit rus, si dhe ndalimin e reklamave të paguara nga këto burime. Sanksionet që shënjestrojnë entitete dhe individë që shpërndajnë narrativa të rreme kanë për qëllim të ushtrojnë trysni ekonomike dhe politike mbi qeverinë ruse dhe të mbrojnë opinionin publik nga ndikimi i dezinformimit dhe propagandës. Në këtë mënyrë mundësohet që informacioni i saktë dhe i besueshëm të jetë i aksesueshëm për qytetarët shqiptarë dhe të vendeve të tjera.

Në përgjigje të kërcënimeve në rritje nga dezinformimi, Shqipëria ka ngritur një Komision për Luftën kundër dezinformimit, bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të datës 14 shkurt 2024, ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA-së për të adresuar manipulimin e informacionit nga aktorët e shteteve të huaja. Ky komision u ngrit me kërkesë të grupit parlamentar të Partisë Socialiste që mban shumicën në parlament dhe u miratua po me votat e tyre më 11 prill 2024.⁵

³ Kuvendi i Shqipërisë (2019) “Rezolutë për ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”. <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20191210141046rezoluta%20per%20nderhyrjet%20e%20huaja%20ne%20proceset%20zgjedhore%20%20dt.%205.12.2019.pdf>

⁴ Reporter.al. (2022, 8 mars). “Kuvendi i Shqipërisë miraton rezolutë në mbështetje të Ukrainës”. <https://www.reporter.al/2022/03/08/kuvendi-i-shqiperise-miraton-rezolute-ne-mbeshtetje-te-ukraines/>

⁵ Kuvendi i Shqipërisë. (2024). “Kërkesë për ngritjen e një Komisioni të Posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë”. <https://faktoje.al/wp-content/uploads/2024/04/kerkesa-per-ngritjen-e-komisionit-per-dezinformimin-1.pdf>

Shoqëria civile në Shqipëri gjithashtu luan një rol aktiv dhe në rritje në luftën kundër dezinformimit. Organizatat e specializuara sidomos në promovimin e gazetarisë cilësore dhe ato të verifikimit të fakteve kontribuojnë prej disa vitesh për të ndërtuar një mjedis informativ të shëndetshëm dhe për të mbrojtur publikun nga ndikimet e huaja të dëmshme.⁶

Shpërndarja e narrativave kundër NATO-s dhe BE-së

Dezinformimi përmes narrativave që shënjestrojnë NATO-n dhe Bashkimin Evropian është një strategji e përdorur nga aktorë të ndryshëm për të manipuluar opinionin publik dhe për të minuar besimin tek institucionet demokratike si Aleanca e Atlantikut të Veriut dhe Bashkimi Evropian.

Aktorët kryesorë që përfshihen në këto fushata të dezinformimit janë kryesisht shtete dhe organizata me interesa që bien ndesh me NATO-n dhe BE-në. Ata synojnë shpesh, duke përfituar edhe nga përparimi i teknologjisë, rrjetet sociale, si edhe taktikat e reja dezinformuese, për të përhapur mesazhe të rreme dhe për të krijuar ndasi brenda dhe midis vendeve anëtare të NATO-s/BE dhe atyre që synojnë integrimin/anëtarësimin. **Ky studim synon të analizojë dhe kuptojë narrativat dezinformuese anti-perëndimore kundër NATO-s dhe BE-së, të përhapura në median shqiptare dhe platformat e mediave sociale.**

Metodat hibride të luftës – të tilla si propaganda, mashtrimi, sabotimi dhe taktika të tjera joushtarake – janë përdorur prej kohësh për të destabilizuar kundërshtarët. E reja në lidhje me sulmet e vërejtura vitet e fundit, siç pranon NATO, është shpejtësia, shkalla dhe intensiteti i tyre, ndihmuar nga ndryshimi i shpejtë teknologjik dhe ndërlihdhja globale. NATO-ja ka një strategji për rolin e saj në kundërvënien e luftës hibride për të mbrojtur Aleancën dhe të gjithë aleatët kundër çdo kërcënimi, qoftë konvencional apo hibrid.

Dezinformimi, sipas përkufizimit të NATO-s, përfshin krijimin dhe shpërndarjen e qëllimshme të informacioneve të rreme ose të shtrembëruara me qëllimin për të mashtruar dhe manipuluar publikun.

⁶ Safe Journalists. (2024, 9 prill). "Open letter: On the establishment of the Special Parliamentary Committee on Disinformation [Letra e hapur: Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar mbi Dezinformimin]". <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2024/04/Open-Letter-SafeJournalists-Network-9.4.2024.pdf>

Në këtë kontekst, autorët e këtij studimi kanë vlerësuar narrativat përçarëse dhe dezinformuese të ndërtuara dhe përsëritura në media nga ndikime të huaja me synimin për të influencuar dhe krijuar perceptime të caktuara në opinionin publik shqiptar dhe më gjerë. Përhapja me shpejtësi e dezinformimit (nga palë të treta keqdashëse), duke përfshirë vendet anëtare të NATO-s ku bën pjesë dhe Shqipëria, ka çuar në ngritjen e masave shtesë kundër dezinformimit dhe aktiviteteve hibride që synojnë manipulimin e opinionit publik dhe minimin e sigurisë.⁷

Aktorët që shpërndajnë kundër NATO-s dhe Bashkimit Evropian janë të ndryshëm, përfshirë fuqi kundërshtare si Rusia, Kina dhe Irani, por edhe politikanë populistë në vendet anëtare.

Rusia është një nga aktorët kryesorë kundërshtarë të NATO-s dhe BE-së, duke e përdorur dezinformimin si një mjet strategjik për të avancuar interesat e saj gjeopolitike.⁸ Strategjia e Rosisë përfshin përhapjen e narrativave që kritikojnë politikën e NATO-s dhe BE-së, theksojnë dobësitë e këtyre institucioneve dhe nxisin ndasi brenda vendeve anëtare. Për shembull, Rusia ka përdorur narrativat e rreme për të justifikuar veprimet e saj ushtarake në Ukrainë, duke akuzuar NATO-n për agresion dhe për ndërhyrje në punët e brendshme të vendeve sovraane. Përmes mediave të kontrolluara nga Kremli dhe fushatave të dezinformimit në mediat sociale, Rusia përpiqet të krijojë një imazh negativ të NATO-s dhe BE-së në sytë e publikut ndërkombëtar.

Irani përdor gjithashtu dezinformimin për të minuar NATO-n dhe BE-në, kryesisht përmes narrativave që i portretizojnë këto institucione si imperialiste dhe si kërcënime për sovranitetin dhe stabilitetin e rajonit të Lindjes së Mesme.⁹ Mediat shtetërore iraniane shpesh përhapin lajme të rreme dhe teoritë konspirative që synojnë të diskreditojnë politikën e NATO-s dhe BE-së dhe të forcojnë pozicionin e vet politik në rajon. Për shembull, Irani ka promovuar

⁷ NATO. (2024). "Countering hybrid threats [Përballja me kërcënimet hibride]". https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_156338.htm

⁸ US Department of State. (2020). "GEC Special Report: Russia's Pillars of Disinformation and Propaganda [Raporti Special i GEC: Shtyllat e Dezinformimit dhe Propagandës së Rosisë]". <https://www.state.gov/russias-pillars-of-disinformation-and-propaganda-report/>

⁹ Stimson. (2024). "Iran and Israel use media and propaganda to try to shape post-attack reality [Irani dhe Izraeli përdorin median dhe propagandën për të tentuar të formësojnë realitetin pas sulmeve]". <https://www.stimson.org/2024/iran-and-israel-use-media-and-propaganda-to-try-to-shape-post-attack-reality/>

teoritë konspirative që NATO-ja dhe BE-ja janë duke mbështetur organizatat terroriste për të destabilizuar qeverinë iraniane dhe për të kontrolluar burimet natyrore të rajonit.

Kina, si një aktor global në rritje, përdor strategji të ngjashme të dezinformimit për të sfiduar dominimin e NATO-s dhe BE-së.¹⁰ Narrativat e përhapura nga Kina shpesh theksojnë që NATO-ja dhe BE-ja janë të papërgatitura për të përballuar sfidat globale dhe se këto institucione janë duke mbështetur një rend ndërkombëtar që favorizon Perëndimin në kurriz të vendeve të tjera¹¹. Përmes platformave të mediave sociale dhe mediave të kontrolluara nga shteti, Kina përhap informacion keqdashës për të minuar besimin tek NATO-ja dhe BE-ja dhe për të promovuar modelin e vet të zhvillimit si një alternativë më tërheqëse dhe efektive.

Përveç shteteve, ka edhe një sërë entitetesh të tjera që përhapin narrativa kundër NATO-s dhe BE-së. Këto përfshijnë politikanë nacionalistë, ekstremistë të djathtë dhe populistë, të cilët shpesh përdorin retorikën anti-NATO dhe anti-BE për të fituar mbështetje politike dhe për të mobilizuar elektoratin e tyre.¹² Politikanë të tillë, për shembull, mund të kritikojnë NATO-n dhe BE-në për ndërhyrje në sovranitetin kombëtar, për promovimin e politikave të hapura ndaj migracionit dhe për ndjekjen e politikave ekonomike që ata i shohin si të dëmshme për interesat kombëtare.

Mediat alternative dhe blogjet e kontrolluara nga ekstremistët e djathtë gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në përhapjen e dezinformimit. Këto platforma shpesh publikojnë përmbajtje që kritikojnë NATO-n dhe BE-në, promovojnë teoritë konspirative dhe përhapin lajme të rreme për të rritur tensionet dhe ndasitë në shoqëri. Përveç

¹⁰ International Institute for Strategic Studies. (2024). "Driving wedges: China's disinformation campaigns in the Asia-Pacific [Shtysë për përçarjeve: Fushatat e dezinformimit të Kinës në rajonin Azi-Paqësor]". <https://www.iiss.org/publications/strategic-dossiers/asia-pacific-regional-security-assessment-2024/chapter-5/>

¹¹ Wintterlin, F., Schatto-Eckrodt, T., Frischlich, L., Boberg, S., Reer, F., & Quandt, T. (2023). "It's us against them up there": Spreading online disinformation as populist collective action ["Jemi ne kundër tyre atje lart": Përhapja e dezinformimit në internet si veprim kolektiv populist]. "Computers in Human Behavior, 146", 107784. <https://doi.org/10.1016/j.chb.2023.107784>

¹² France24. (2024, May 6). "Far-right parties wage disinfo war ahead of EU vote [Partitë e ekstremit të djathtë zhvillojnë luftë dezinformimi para votimit të BE-së]". <https://www.france24.com/en/live-news/20240506-far-right-parties-wage-disinfo-war-ahead-of-eu-vote>

kësaj, organizatat joqeveritare dhe “think tank”-et me agjenda të caktuara politike mund të përhapin narrativa dezinformuese për të çuar përpara qëllimet e tyre dhe për të ndikuar/manipuluar perceptimin e opinionit publik.

Dezinformimi kundër NATO-s dhe BE-së është një strategji komplekse dhe e shumanshme, e përdorur nga një sërë aktorësh me interesa të ndryshme. Këto përpjekje synojnë të minojnë besimin tek institucionet demokratike dhe të destabilizojnë rendin ndërkombëtar.

Metodologjia

Bashkimi Evropian në Kodin e tij të Praktikës, që përcakton standardet rregulluese për platformat online, rrjetet sociale si dhe industrinë e reklamuesve online, e përcakton dezinformimin si “informacion i cili është verifikuar si i gabuar apo shtrembëruar [...] që hartohet dhe shpërndahet për përfitime ekonomike ose me qëllim për të mashtruar një publik të gjerë” dhe që “paraqet rrezik për sistemet politike demokratike, ato të vendimmarrjes dhe publikun.”

Në të njëjtën linjë, NATO-ja jep këtë përkufizim për dezinformimin si: “krijimi dhe shpërndarja e qëllimshme e informacioneve të rreme/shtrembëruara me synimin për të mashtruar/manipuluar.”

Gjithashtu, jep edhe një përcaktim për narrativat si: “një sistem elementësh- që përfshin aktorë, ngjarje dhe rrethana të shprehura në media, që reflektojnë ngjarje të ndodhura në realitet- dhe që na ndihmojnë për të kuptuar ndërveprimet mes tyre.”

Ndërkohë, narrativat përçarëse përcaktohen si: “... narrativa të ndërtuara dhe përsëritura në media nga ndikime të huaja (aktorë shtetërorë, jo-shtetërorë apo faktorë të tjerë) me synimin e padrejtë për të influencuar opinionin publik”.

Si rrjedhim, në narrativat dezinformuese mund të dallojmë këto elementë:

a) një qëllim të caktuar të përçuesve të mesazheve për të shpërndarë informacione që ata e dinë që nuk janë të vërteta dhe të inkurajojnë publikun që t'i besojë;

b) shpërndarësit e informacioneve nisen nga qëllime të këqija.

Ndërkohë për të qartësuar se çfarë konsiderohen si narrativa anti-perëndimore ky studim ky fokusohet në të ashtuquajturat vlera perëndimore.

Neni 2 i Traktatit të themelimit të Bashkimit Evropian (BE) përcakton vlerat mbi të cilat është themeluar BE-ja: ...

vlerat e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, forcimin e ligjit dhe respektin për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e individëve që i përkasin pakicave.

Si rrjedhim, ky studim do të fokusohet në monitorimin e narrativave dezinformuese anti-Perëndimore në median shqiptare dhe platformat e mediave sociale për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve kërkimore:

1. Deri në ç'masë ka narrativa anti-Perëndimore të përhapura nëpërmjet medias apo platformave të mediave sociale në Shqipëri?
2. Cilat janë narrativat kryesore anti-Perëndimore të përhapura në Shqipëri?
3. Cilët janë aktorët që angazhohen më shumë në përhapjen/përforcimin e narrativave anti-perëndimore në Shqipëri?
4. Kush janë faktorët që mundësojnë shpërndarjen e narrativave anti-Perëndimore në median shqiptare?

Përzgjedhja e mediave dhe platformave të mediave sociale është bazuar në dy elementë:

1. Popullariteti i këtyre mediave/platformave sociale
2. Fushat/tematikat që trajtojnë

Në këtë mënyrë është bërë e mundur që të monitorohet një gamë e gjerë përmbajtjeje mediatike.

Si pjesë e këtij studimi u përzgjedhën 36 media shqiptare me faqe online, përfshirë televizione kombëtare dhe rajonale, gazeta dhe portale online.

Një element i rëndësishëm për këtë studim është shqyrtimi se sa rezonojnë këto narrativa me publikun në Shqipëri. Nëpërmjet përdorimit të aplikacionit Crowdtangle, studimi do të paraqesë të dhëna mbi popullaritetin e këtyre narrativave mes audiencave të ndryshme në median sociale, duke u fokusuar te kuantifikimi i ndikimit që kanë këto narrativa në bazë të indikatorëve të ndryshëm siç mund të jenë: numri i shpërndarjeve të publikimit, niveli i pëlqimit apo komenteve që marrin. Këta indikatorë të sjellë së bashku mund të na japin një të kuptuar më të qartë të qëndrimit që kanë audiencat në Shqipëri ndaj këtyre narrativave.

Përzgjedhja e artikujve për monitorim

Për përzgjedhjen e artikujve në mediat online dhe platformat e mediave sociale është përdorur aplikacioni SentiOne. Më anë të këtij mjeti është bërë e mundur të identifikohen të gjitha publikimet për NATO-n dhe BE-në (n=196,157) e sipërpërmendura për periudhën 15 maj 2023 - 15 maj 2024, të cila u filtruan nëpërmjet fjalëve kyçe për aktorë kundërshtarë duke përfutur 15,177 artikuj.

Fjalët kyçe u përfutur nga studimet e mëparshme mbi dezinformimin kundër NATO-s dhe BE-së, si dhe nga përdorimi i inteligjencës artificiale ose 'Natural Language Processing Model' nga Sentione.

Fjalë kyçe të përdorura

Lavrov, Putin, Robert Fico, Viktor Orban, Maria Zakharova, Dmitry Peskov, Gerasimov, Shoigu, Lukashenko, Ibrahim Raisi, Tomasz Szmydt, Vyacheslav Volodin, Dodik, Erdogan Escobar, Lajcak, Fredi Beleri, Soros, Nord Stream, Moska, Ria Novosti, Izvestia, Rossiyskaya Gazeta, Voice of Europe, Sputnik, Russia Today, Rusia Sot, Sputink, media ruse, mediat ruse, Kina, Pekini, Moska, Rusia, Teherani, Kremlini, Minks, Bjellorusia, Bjellorus, globalist, globaliste, regjime globaliste, sovraniteti, sovran, fronti dytë, junta e Kievit, legjitimiteti, Crocus City, mafia, luftë me Rusinë, nazizëm, revansh, uzurpues, hegjemoni, hegjemonia, kolaps, jodemokratike, lufta hibride, vlerat tradicionale, vlerat e familjes, grusht shteti, kristianizmi, imoralitet, koloni, dështuar, neonazist, CIA, përshkallëzon, bërthamore, Rama-Meloni, pakti Rama-Meloni

Artikujt e përfutur pas filtrimit me fjalë kyçe (n=15,177) u koduan nga një hulumtues me eksperiencë nëse përmbanin narrativa pro/mbështetëse të NATO/BE, neutrale ose narrativa dezinformuese/përçarëse. Narrativa dezinformuese u koduan më tej sipas aktorit kundërshtar (individit), medias që ka shërbyer si burim i lajmit, temës ose ngjarjes së ndërlidhur. Nëpërmjet aplikacionit "Crowdtangle" u regjistruan të gjitha ndërveprimet (like, share dhe komentet) në Facebook me artikujt dezinformues.

Pas analizimit të të dhënave sasiore nëpërmjet një databaze dhe tabelave "pivot" në Excel, autorët ndërmorën një seri intervistash të thelluara me gazetarë, redaktorë dhe drejtues mediash në publikimet e të cilave u identifikuan artikuj dezinformues kundër NATO-s dhe BE. Këto intervista kishin si qëllim të identifikonin arsyet/faktorët për shpërndarjen/publikim e artikujve me përmbajtje dezinformuese.

Përmbledhje e gjetjeve kryesore

- Nga më shumë se 193 mijë artikuj që përmbanin fjalë kyçe të lidhura me NATO/BE, u identifikuan 15,177, të cilat përfshinin si subjekt ose objekt të raportimit aktorë kundërshtarë/individë. Nga këta 1,263 artikuj përmbanin narrativa dezinformuese/përçarëse kundër NATO-s, Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare.
- Mes narrativave dezinformuese mbizotërojnë ato që e portretizojnë Bashkimin Evropian dhe NATO-n si “ekspansionistë”, me politika të dëmshme në kurriz të Rusisë dhe vendeve të tjera “shërbëtore” të SHBA-së dhe zvatëse, shkatërruese të vlerave tradicionale, shkaktare të luftërave dhe shtypëse të popujve apo si rrezik për lirinë e medias (për shkak të mbylljes së mediave pro-ruse). Narrativat që lidhen me pakicat si refugjatët, komuniteti LGBTQ dhe grupe të tjera vulnerabël - për të cilat BE-ja ka vendosur kushte sa i përket respektimit të të drejtave - janë një element tipik i dezinformimit që vjen nga Kremli, i cili i targeton ato si “kërcënuese të vlerave tradicionale” dhe promovuese të degjenerimit të moralit dhe perversionit.
- Tiparet dalluese të artikujve dezinformues janë: Mungesa e emrit të autorit/gazetarit që ka shkruar artikullin; Tituj sensacionale/bombastike, shpesh të pasaktë ose pretendime të paverifikuara; Artikulli i referohet vetëm një burimi, që në shumicën e rasteve është burim shtetëror rus, politikan populist, agjenci lajmesh, zyrtar rus ose aktorë të tjerë kundërshtarë; Lajmi është i përkthyer automatikisht dhe ka gabime në koncepte ose fjalë; Narrativa të njëjta përsëriten/riciklohen dhe sillen si artikuj të rinj në periudha të ndryshme.
- Studimi vëren se këto narrativa janë marrë nga media pro-ruse ose media të tjera të huaja dhe janë publikuar “copy-paste” pa kaluar në asnjë filtër editorial në mediat shqiptare.
- Aktorët që kanë shpërndarë më shumë këto narrativa dezinformuese përfshijnë zyrtarë të lartë të qeverisë së Rusisë; në disa raste këto narrativa kanë si burim politikanë nacionalistë si Viktor Orban, Donald Trump, Aleksandër Vucic apo Recep Tayyip Erdogan.

- Të gjithë shkrimet e identifikuarra (n=1263), të cilat përmbanin narrativa kundër NATO-s dhe BE-së, kanë regjistruar në total 16,938 ndërveprime (“likes”, “emoji” ose komente) në Facebook, ose mesatarisht 13 ndërveprime për shkrim.
- Në total, u identifikuan 77 aktorë që shpërndajnë narrativa kundër NATO-s dhe BE-së në median shqiptare. Mesatarisht, çdo aktor armiqësor ose kundërshtar, i cili ka shpërndarë narrativa kundër NATO-s dhe Bashkim Evropian është cituar në 16 shkrime të botuara në median shqiptare.
- Narrativa me ndërveprimin më lartë është “kërcënimi i luftës bërthamore midis Rusisë dhe NATO-s”, ndërsa aktori kundërshtar me më shumë ndërveprime në Facebook është Vladimir Putin, i ndjekur nga Viktor Orban, Dmitry Peskov, Sergej Lavrov dhe Recep Tayyip Erdogan.
- Intervistat e thelluara me përfaqësues të mediave kryesore në Shqipëri dhe ekspertë kundër dezinformimit nxorën në pah sfidat kryesore me të cilat ata përballen si: mundësi financiare ose burime njerëzore të kufizuara për të mbuluar në mënyrë të pavarur lajmet mbi krizat dhe konfliktet ndërkombëtare apo mbi institucione ndërkombëtare si NATO-ja dhe Bashkimi Evropian; mungesa e një strukture të mirëfilltë editoriale dhe mungesa e procedurave të korrigjimit të këtyre lajmeve në pjesën më të madhe të mediave, si dhe mungesa e njohurive të thelluara mbi NATO-n dhe BE-në. Si pasojë e këtyre faktorëve, media shqiptare mbështetet kryesisht në informacionet e transmetuara nga burime të huaja dhe ka më pak mundësi për raportime të pavarura ose hulumtuese mbi këto tema. Kjo e rrit rrezikun që ato të shërbejnë si kanale për përhapjen e dezinformimit.
- Nga këndvështrimi i gazetarëve dhe ekspertëve të intervistuar, dezinformimi anti-NATO dhe anti-BE nuk përbën ende një kërcënim të drejtpërdrejtë për politikën apo stabilitetin në Shqipëri, por mbetet një fenomen që duhet monitoruar, në një kohë kur teknologjitë digjitale dhe rrjetet sociale po e bëjnë gjithnjë e më të lehtë shpërndarjen e lajmeve të rreme dhe narrativave nga aktorë kundërshtarë.

Gjetjet e monitorimit

Në median shqiptare në internet, kryesisht ato me numër të lartë ndjekësish në platformat sociale, bie në sy publikimi konstant i lajmeve mbi luftën në Ukrainë, përfshirë portretizimin e rolit të NATO-s dhe BE-së në këtë kontekst. Frekuenca e këtyre raportimeve vërehet më e lartë sa herë ka evente/ngjarje ndërshtetërore/diplomatike ushtarake dhe politike, si për shembull samitet e NATO-s, BE-së, stërvitje të përbashkëta ushtarake apo takime të aktorëve shtetërorë - sidomos ato në lidhje me arritjen e paqes në Ukrainë, mbrojtjen e Ukrainës nga bombardimet ruse, si dhe mundësinë e anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian apo aleancën e NATO-s.

Këto lloj tematikash zunë vend gjithnjë në rritje në hapësirën mediatike shqiptare – sidomos në mediat kryesore online dhe që kanë numër më të madh ndjekësish - që prej nisjes së sulmit të Rusisë në shkallë të plotë në shkurt 2022. Në periudhën 2014-2022, gjatë pushtimit të pjesshëm të Ukrainës nga Rusia duke aneksuar Krimenë dhe mbështetur lëvizjen separatiste në Donbas, raportimi i këtyre temave ishte sporadik dhe periferik sa i përket renditjes-ekspozimit në hapësirën online. Ndërsa pas shkurtit 2022, temat që lidheshin me Ukrainën, Rusinë, NATO-n/BE-në dhe aktorë të tjerë të përfshirë shënuan praninë e përditshme dhe në krye të faqeve kryesore.

Përparimi i teknologjisë ndërkohë e ka rritur edhe më shumë ndërveprimin e audiencës ndaj raportimeve të tilla, të cilat kanë ndjeshmëri të lartë te publiku për shkak se lidhen me jetën, sigurinë, rendin dhe ekonominë. Publikimet në këtë kontekst në median shqiptare u intensifikuan vazhdimisht, me angazhimin në rritje dhe ndihmën që NATO-ja, BE-ja dhe SHBA-ja po i ofrojnë Ukrainës, e cila ndodhet ende nën agresionin e Rusisë.

Në këtë studim jemi përqendruar në analizimin e dy grupeve kryesore të narrativave dezinformuese, narrativat që shënjestrojnë NATO-n dhe narrativat kundër BE-së (shih Figure 1).

NARRATIVAT

● BE ● NATO




Figure 1: Narrativat kundër NATO-s dhe BE-së

Nga më shumë se 193 mijë artikuj që përmbanin fjalë kyçe të lidhura me NATO-n/BE-në, autorët e këtij studimi identifikuan 15,177, të cilat përfshinin si subjekt ose objekt të raportimit aktorë kundërshtarë/individë, të cilët shpërndajnë narrativa dezinformuese. Narrativat që përmbajnë këto artikuj u vlerësuan në shumicën e rasteve si neutrale (n=13,574), në disa raste me sentiment pro-NATO-s ose BE-së, ndërsa në një minorancë (n=1263) me narrativa dezinformuese/përçarëse kundër NATO-s, Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare.

Mes narrativave dezinformuese mbizotërojnë ato që e portretizojnë Bashkimin Evropian dhe NATO-n si “ekspansionistë”, me politika të dëmshme në kurriz të Rusisë dhe vendeve të tjera “shërbëtoresh” të SHBA-së dhe zhatëse, shkatërruese të vlerave tradicionale, shkaktoresh të luftërave dhe shtypëse të popujve. Edhe pse shifrat tregojnë një kuotë relativisht të ulët në krahasim me artikujt me përmbajtje neutrale, narrativat dezinformuese kanë tendencë për t’u përhapur, pasi klima mediatike dhe polarizimi i shoqërisë dhe politikës përbëjnë një mjedis pjellor për përhapjen e tyre.

Tjetër element që favorizon rritjen e dezinformimit për interesa keqdashëse të aktorëve kundërshtarë janë: niveli i ulët i lirisë së medias, niveli i lartë i korrupsionit, përqendrimi i tregut të medias në pak duar dhe tek individë të lidhur me interesa politike/shtetërore, shkelja e të drejtave dhe keqpagimi i gazetarëve. Duhet mbajtur parasysh se metodat e gjithnjë e më të sofistikuara për prodhimin dhe përhapjen e dezinformimit përmes Inteligjencës Artificiale si “deepfake” dhe “operacione informacioni” e bëjnë edhe më të depërtueshëm mjedisin e brishtë mediatik dhe audiencën në Shqipëri.

Synimi i këtyre operacioneve është të imponojnë perceptime të gabuara dhe pikëpamje keqdashëse në ndërgjegjen kolektive dhe individuale, me pasojë çorientimin dhe dezinformimin e publikut, duke minuar besimin e tij në institucione, duke i shkaktuar frikë për stabilitetin dhe sigurinë përmes portretizimit si armik ose të dëmshëm të NATO-s dhe BE-së.

Ndaj, monitorimi dhe analizimi i përmbajtjes së artikujve me këtë qasje, shpjegimi përse këto narrativa janë dezinformuese dhe të rrezikshme ndihmon në informimin dhe edukimin e medias, profesionistëve dhe shoqërisë mbi rolin real që organizma si NATO-ja dhe BE-ja kanë në të vërtetë, kundrejt imazhit që tentohet të krijohet përmes manipulimit të opinionit publik.

Ky studim ka identifikuar dhjetëra narrativa dezinformues të përhapura kundër NATO-s dhe vendeve anëtarë në median shqiptare. Këto narrativa synojnë të diskreditojnë rolin e NATO-s dhe përmbajnë tone kundër Aleancës së Atlantikut të Veriut, ku Shqipëria është vend anëtar. Është e rëndësishme të theksohet se këto narrativa janë marrë dhe publikuar kryesisht “copy-paste” nga media pro-ruse ose media të tjera të huaja.

Tiparet dalluese që i bëjnë këta artikuj dezinformues, për shkak të narrativave që shpërndajnë, janë:

- Mungesa e emrit të autorit/gazetarit që ka shkruar artikullin. Më rrallë vendosen iniciale, emri i portalit/ medias që e publikon.
- Artikulli hapet me tituj sensacionale/bombastike, shpesh të pasaktë ose pretendime të pa verifikuara.
- Artikulli i referohet vetëm një burimi, që në shumicën e rasteve është burim shtetëror rus, politikan populist, agjenci lajmesh, zyrtar rus ose aktorë të tjerë kundërshtarë .
- Lajmi është i përkthyer automatikisht dhe ka gabime në koncepte ose fjalë.
- Narrativa të njëjta përsëriten/riciklohen dhe sillen si artikuj të rinj në periudha të ndryshme.

Më poshtë po paraqesim 10 narrativat më të shpërndara kundër NATO-s në median shqiptare gjatë periudhës së monitorimit. Për çdo narrativë do të paraqesim një përshkrim të detajuar dhe një zberthim të saj për të kuptuar më mirë elementët dezinformues që narrativa përcjell.

Narrativa 1: NATO dhe Perëndimi po provokojnë/kërcënojnë një konflikt me Rusinë ndaj Rusia është e detyruar të përdorë armë bërthamore. Ka rrezik të shpërthejë Lufta e III Botërore midis vendeve të NATO-s dhe Rosisë.

Putin pas fitores në zgjedhje: Nëse NATO ndërhyt në Ukrainë, jemi një hap larg Luftës së Tretë Botërore

Bota
Moska: NATO po përgatitet për një përplasje të mundshme me ne

Përshkrimi i narrativës:

Fajësimi i NATO-s se po bëhet shkak që Rusia të përdorë armët bërthamore dhe të shkatërrojë njerëzimin është një ndër narrativat më të përhapura, sidomos nga presidenti i Rosisë Vladimir Putin dhe përfaqësues të tjerë të lartë të Kremlinit. Kjo narrativë, e cila haset në të paktën 172 artikuj të publikuar nga media në Shqipëri, vjen në kontekstin e kërcënimit që presidenti i Rosisë, Vladimir Putin, bëri në vitin e dytë që nga nisja e sulmit të Rosisë ndaj Ukrainës në shkallë të plotë. Ky moment përkon gjithashtu me deklaratën e presidentit francez, Emanuel Macron, mbi mundësinë e dërgimit të trupave në Ukrainë, por edhe me vendimmarrjet e NATO-s për të ndihmuar Ukrainën dhe për të ruajtur stabilitetin dhe paqen e vendeve anëtare të Aleancës. Përgjithësisht, kjo narrativë identifikohet në tituj sensacionalë që përçojnë frikë dhe panik tek audienca/lexuesit, duke cituar përgjithësisht deklaratat kërcënuese për luftë të aktorëve kundërshtarë. Një pjesë e vogël e mediave janë kujdesur të jenë të balancuara që në titull duke dhënë një qëndrim të paanshëm. Ndërsa shumica e mediave i fryjnë narrativës së luftës dhe konfliktit.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

“Copy-Paste” dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt që përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë, ose politikanëve të ekstremit të djathtë evropian, të cilat shpesh përkthehen automatikisht dhe publikohen në portale dhe media shqiptare pa ndryshime të mëdha, duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Aktorët që kanë shpërndarë narrativën dezinformuese: Zyrtarë të lartë të qeverisë ruse si Vladimir Putin, Dymtri Medvedev dhe politikanë evropian si Matteo Salvini.

Vladimir Putin, Presidenti Federatës Ruse:

“Shtetet Perëndimore duhet të kuptojnë se edhe ne kemi armë që mund të godasin objektivat në territorin e tyre. E gjithë kjo kërcënon realisht në një konflikt për përdorimin e armëve bërthamore dhe shkatërrimin e qytetërimit. Nuk e kuptojnë ata këtë?”

Media që kanë qenë burim i artikujve dezinformues: Ria Novosti, Tass

Zbërthimi i narrativës:

NATO-ja nuk e ka kërcënuar Rusinë as se do ta sulmojë dhe as se do t'i shpallë luftë. NATO-ja ka deklaruar qartë se nuk kërkon konflikt/konfrontim me Rusinë. NATO-ja mbështet Ukrainën në të drejtën e saj për t'u vetëmbrojtur, siç parashikohet edhe në kartën e Kombeve të Bashkuara. Vendimet e NATO-s, që lidhen me mbështetjen e Ukrainës dhe forcimin e vetëmbrojtjes, janë një përgjigje që vjen si pasojë e akteve agresive të Ruisisë. NATO-ja e ka bërë të qartë dhe pa lënë ekuivokë se ajo është gatshme të mbrojë të gjithë aleatët dhe kufijtë e saj dhe të garantojë lirinë dhe demokracinë e çdo vendi anëtar, ashtu siç përcaktohet në Artikullin 5 të Traktatit të Uashingtonit.

Narrativa 2: Armët Perëndimore për Kievin përshkallëzojnë luftën në Ukrainë

BOTA

“Përgjigje asimetrike Perëndimit”- Kërcënon Putin: Do armatosim rivalët e NATO-s

BOTA

Moska paralajmëron përshkallëzim, pasi Ukraina mund të përdorë armë perëndimore

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

“Sy për sy, dhëmb për dhëmb”/ Putin: Rusia do armatosë vendet “anti-perëndimore”

Përshkrimi i narrativës:

Kjo është një narrativë e përhapur masivisht nga aktorë kundërshtarë dhe mediat pro-Kremlinit për të devijuar përgjegjësinë e Rusisë si agresore ndaj Ukrainës. Përmes kësaj narrative synohet të manipulohet perceptimi publik ndaj sulmit rus se kjo është një luftë e padrejtë mes Rusisë përballë krejt Perëndimit që favorizon Ukrainën. Deklaratat që fajësojnë Perëndimin, dhe konkretisht NATO-n, se duke dhënë armë për Ukrainën dhe duke e lejuar atë t'i përdorë për të sulmuar Rusinë, përbëjnë një narrativë të ricikluar shpesh nga zyrtarët ruse dhe aleatë të saj në shtete të tjera. Kjo narrativë deiznformuese ka gjetur hapësirë edhe në titujt dhe përmbajtjen e të paktën 65 artikujve në shumicën e mediave shqiptare online.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

— Aktorët që kanë shpërndarë narrativën dezinformuese: Zyrtarë të lartë të qeverisë së Rusisë si Vladimir Putin, Dmitry Peskov, Maria Zakharova ose politikanë evropianë si Viktor Orban.

Dmitry Peskov, zëdhënës i Kremlinit:

“Shohim një përshkallëzim të tillë verbal nga përfaqësues zyrtarë. E shohim si në nivelin e krerëve të shteteve, kur bëhet fjalë për Francën, ashtu edhe në një nivel më profesional, kur bëhet fjalë për Britaninë e Madhe. Këto janë përshkallëzime të drejtpërdrejta të tensionit rreth konfliktit të Ukrainës, të cilat potencialisht mund të përbëjnë rrezik për sigurinë evropiane, për të gjithë arkitekturën e sigurisë së Evropës.”

— Media që kanë qenë burim i artikujve dezinformues: Ria Novosti, Tass, Tucker Carlson Netëork

Zbërthimi i narrativës:

Në të vërtetë SHBA-ja, BE-ja dhe NATO-ja mbështesin Ukrainën financiarisht, ushtarakisht dhe me ndihmë teknike në mënyrë që ky vend (Ukraina) të ketë mundësinë të vetëmbrohet ndaj sulmit që nuk është provokuar prej saj. Kjo e drejtë rrjedh nga Neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara. Në janar 2023, presidenti ukrainas Volodimir Zelensky paraqiti një propozim paqeje me 10 pika për armëpushim me Rusinë (formulë që mbështetet edhe nga BE-ja), por Rusia refuzon, duke vijuar bombardimet dhe agresionin ushtarak. Vendet perëndimore nuk janë të interesuara për vazhdimin e luftës në zemër të Evropës dhe as për përshkallëzimin e konfliktit duke ndihmuar Ukrainën. Përkundrazi,

përmes ndihmës Perëndimi synon të mbështesë Ukrainën të zbrapsë agresionin e paprovokuar dhe të pajustificuar të Rusisë dhe të ruajë integritetin territorial brenda kufijve të vet, të njohur ndërkombëtarisht.

Narrativa 3: Anëtarësimi i Ukrainës në NATO kërcënon sigurinë kombëtare të Rusisë dhe nxit Luftën III Botërore.

Drita
Paralajmëron Putin: Anëtarësimi i Ukrainës në NATO do ta bëjë botën më të "cënueshme"

paralajmëron: 13.02
Putin reagon pas samitit të NATO-s: Do të tërhiqemi nga marrëveshja e grurit

Filipi > 2023
Putin del me paralajmërimin 'e frikshëm', ja çfarë 'pasojash' do të sjellë anëtarësimi i Ukrainës në NATO

Medvedev: Rusia është kërcënuar nga anëtarësimi i mundshëm i Ukrainës në NATO

Filipi > 2023
Lufta e Tretë Botërore mund të fillojë për pak orë? Parashikuesi i njohur bën paralajmërimin e frikshëm

Përshkrimi i narrativës

Deklaratat e zyrtarëve rusë, të cilëve iu është bashkuar edhe kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, janë përhapur

kryesisht nga mediat qeveritare të Rosisë që e propagandojnë si të rrezikshëm dhe kërcënues të paqes dhe sigurisë globale hyrjen e Ukrainës në NATO. Në mediat shqiptare artikujt me këtë narrative gjatë periudhës monitoruese janë 68 dhe bazohen kryesisht në deklaratat zyrtare të aktorëve kundërshtarë. Ato janë shpërndarë me frekuencë më të lartë në prag dhe pas samitit të mbajtur të NATO-s në verën e viti 2023 në Vilnius, por edhe gjatë stërvitjeve ushtarake të NATO-s, samiteve dhe takimeve për arritjen e paqes në Ukrainë, apo vendimmarrjeve për ndihmën ushtarake ndaj këtij shteti. Përmes kësaj narrative synohet të diskreditohet roli mbrojtës i aleancës dhe të dekurajohet mbështetja e Ukrainës në rrugën e saj të anëtarësimit në NATO.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— **Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë:** Artikujt përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Viktor Orban, kryeministri i Hungarisë:

“Po të kishim pranuar Ukrainën në NATO, kjo do të nënkuptonte luftë të menjëhershme botërore.”

— **Aktorët që shpërndajnë narrativën:** Vladimir Putin, Dmitry Medvedev, Sergey Lavrov, Viktor Orban

— **Media që kanë qenë burim i artikujve dezinformues:** Rossiyskaya Gazeta

Zbërthimi i narrativës:

Anëtarësimi i Ukrainës në NATO nuk kërcënon sigurinë dhe paqen e asnjë shteti, sa kohë misioni i aleancës është ruajtja dhe garantimi i tyre. Aq më pak provokon një luftë, ndërsa vendet aleate angazhohen të mbrojnë njëri-

tjetrin apo të vetëmbrohen nga sulmet, bazuar në nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. NATO-ja nuk e ka kërcënuar Rusinë, por ka kërkuar vazhdimisht nga Rusia të tërhiqet nga agresioni ndaj Ukrainës.

Është e drejta e Ukrainës, ashtu si e çdo shteti, që të zgjedhë vullnetarisht nëse do të bëjë pjesë ose jo në aleancë, nëse pajtohet me detyrimet e saj.

Anëtarësimi i Ukrainës në NATO do të ndodhë dhe ky angazhim është marrë në samitin e NATO-s në Vilnius, ku rikonfirmohet mbështetja ndaj këtij anëtarësimi i lançuar që në vitin 2008 në samitin e Bukureshtit. Në vitin 2023 aleatët ranë dakord të heqin kërkesën për një Plan Veprimi Anëtarësimi, duke ndryshuar rrugën e anëtarësimit të Ukrainës nga një proces me dy hapa në një proces me një hap.

NATO-ja ka rënë gjithashtu dakord për një program të ri shumëvjeçar ndihme për të ndihmuar forcat e armatosura ukrainase të kalojnë nga epoka sovjetike në standardet e NATO-s dhe të forcojnë sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes së Ukrainës për t'i rezistuar agresionit të mëtejshëm rus.

Narrativa 4: NATO me zgjerimin e saj po rrethon Rusinë, stërvitjet në kufirin me Rusinë provokime dhe kërcënime të Perëndimit ndaj Rusisë

Rusia kundër NATO-s: Jemi në konfrontim të drejtpërdrejtë

Bota

Moska: NATO po përgatitet për një përplasje të mundshme me ne

Rusia kundërshton stërvitjet e NATO-s në Finlandë: Rrezikojnë incidente të mundshme

Home » Bota

Rrezik për një konflikt me NATO-n?
Rusia e trembur, Lavrov: Deklarata e Austin tregoi se SHBA e ka një plan

Përshkrimi i narrativës:

Kjo narrativë e zyrtarëve të Kremlinit, e përhapur masivisht nga mediat pranë qeverisë ruse, tenton të krijojë bindjen se anëtarësimi i shteteve në kufi me Rusinë në NATO bëhet me qëllim izolimin, rrethimin e Rusisë dhe nxitjen e konflikteve ushtarake NATO-Rusi. Kjo narrativë ka depërtuar në mediat shqiptare në të paktën 50 artikuj, një pjesë e të cilëve janë publikuar “copy-paste” nga një portal te tjetri.

Deklaratat dhe artikulet e zyrtarëve rus kanë qenë më të shpeshta gjatë periudhës së dy anëtarësimeve të reja

në NATO, të Finlandës në pranverën e 2023 dhe më pas Suedisë.

Aktorët kundërshtarë janë përpjekur ta portretizojnë NATO-n në këtë aspekt si ekspansionste dhe provokuese, me pretendimet se NATO-ja ka rritur izolimin e Rusisë duke zgjeruar perimetrin me praninë e forcave dhe mjeteve të saj ushtarake dhe, së dyti, ka nxitur provokime përmes kryerjes së stërvitjeve të përbashkëta ushtarake me aleatët e rinj në kufi me Rusinë.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— **Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktoriale:** Artikujt përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

— **Aktorët që kanë shpërndarë narrativën dezinformuese:** Vladimir Putin, Sergey Lavrov, Maria Zaharova, Dmitry Peskov

Maria Zakharova, Zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtme Ruse:

“Vendimi i Suedisë për t’u bashkuar me NATO-n do të kontribuonte në transformimin e rajonit të Baltikut dhe Evropës Veriore nga një zonë stabiliteti dhe bashkëpunimi në një zonë konfrontimi të mundshëm.”

— **Media që kanë qenë burim i artikujve dezinformues:** Nuk identifikohen mediat që kanë shërbyer si burim.

Zbërthimi i narrativës:

Me anëtarësimin e Finlandës në aleancë, perimetri i kufirit tokësor të NATO-s me Rusinë gati u dyfishua. Megjithatë Rusia ndan vetëm 11% të kufijve të saj me shtete anëtare të NATO-s. Është e vështirë të rrethosh/izolosh një vend me njëmbëdhjetë zona të ndryshme kohore.

NATO-ja pezulloi bashkëpunimin praktik me Rusinë - duke ruajtur dialogun politik dhe ushtarak, si reagim ndaj aneksimit të paligjshëm të Krimesë prej saj dhe destabilizimit të Ukrainës Lindore në vitin 2014. Në vitin 2016, NATO-ja dislokoj katër grupe beteje shumëkombëshe në shtetet Baltike dhe Poloni, vende ku para veprimeve agresive të Ruisë në vitin 2014 nuk kishte dislokim të trupave të NATO-s të gatshme për luftim.

Pas fillimit të agresionit të plotë të Ruisë ndaj Ukrainës në vitin 2022, NATO-ja rriti masat parandaluese dhe mbrojtëse, duke dyfishuar numrin e grupeve luftarake shumëkombëshe në lindje të Aleancës - nga katër në tetë - duke vendosur 40,000 trupa nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s.

Stërvitjet dhe dislokimet ushtarake të NATO-s nuk synojnë provokimin apo kërcënimin ushtarak kundër Ruisë apo ndonjë vendi tjetër. Janë veprimet agresive të Ruisë që kanë shkatërruar paqen në Evropë dhe po minojnë sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar. Përveç agresionit të saj kundër Ukrainës, Rusia ka baza ushtarake dhe ushtarë në Gjeorgji dhe Moldavi, pavarësisht mospëlqimit të qeverive respektive.

Narrativa 5: Me politikën e saj ekspansioniste, NATO-ja ndërhyt në punët e brendshme të Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës.

“NATO në Ballkan sjell vdekje”, Rusia: Stoltenberg provokoi në Serbi dhe Bosnje-Hercegovinë

Home > Bota

“NATO në Ballkan sjell vdekje”. Rusia: Stoltenberg provokoi në Serbi dhe Bosnje-Hercegovinë

Përshkrimi i narrativës:

Një narrativë e nxitur nga zyrtarët e Rusisë dhe makineria propagandistike është se NATO-ja po nxit tension dhe shkatërrim në Ballkan duke iu imponuar shteteve të këtij rajoni hyrjen në aleancë. Kjo narrativë përfshin deklarata të zyrtarëve rusë dhe citime të mediave ruse, të cilat pretendojnë se NATO-ja po destabilizon rajonin. Studimi ka identifikuar të paktën 30 artikuj që shpërndajnë këtë narrativë.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Targetimi i Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës: Artikujt synojnë të përçojnë mesazhin se NATO-ja po ndërhyr në Ballkan, duke theksuar Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën si shembuj. Kjo bëhet për të përfituar nga ndjeshmëritë historike dhe politike në këto vende ndaj NATO-s.

Rishfaqja e precedentëve të mëparshëm: Tensionet etnike dhe luftërat e mëparshme në këto dy vende risillen si kërcënim real për përsëritjen e tyre, me NATO-n që cilësohet si nxitëse.

Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt që përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë shpesh përkthehen automatikisht dhe publikohen në portale dhe media shqiptare pa ndryshime të mëdha, duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Aktorët që kanë shpërndarë narrativën dezinformuese: Zyrtarë të lartë të qeverisë së Rusisë.

Maria Zakharova, Zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtme Ruse:

“Ne besojmë se NATO-ja duhet t’i japë fund politikës së saj që synon destabilizimin e Ballkanit, imponimin e rregullave të saj në rajon dhe vendosjen e vijave të reja ndarëse atje. Siç tregon historia, ndikimi i aleancës në Ballkan gjithmonë çon në pikëllim, humbje jete, shkatërrim dhe krime lufte.”

Media që kanë qenë burim i artikujve dezinformues: Russia Today (RT), Sputnik, Tass

Zbërthimi i narrativës

Narrativa e shpërndarë se NATO-ja synon destabilizimin e Ballkanit, imponimin e rregullave të saj në rajon dhe vendosjen e vijave të reja ndarëse është e pabazuar në fakte. Në të vërtetë, NATO-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkan. Në Bosnje dhe Hercegovinë, misioni paqeruajtës i NATO-s (IFOR dhe më vonë SFOR) ka kontribuar në zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit, që i dha fund luftës në Bosnje. Në Kosovë, misioni i NATO-s (KFOR) ka qenë kyç për sigurinë dhe stabilitetin në rajon pas konfliktit të vitit 1999.

Gjithashtu, anëtarësimi në NATO, ndryshe nga pretendimi i zyrtarëve rusë, është një proces vullnetar dhe i drejtuar nga vetë vendet që kërkojnë të bëhen pjesë e aleancës. NATO-ja nuk i imponon anëtarësimin asnjë vendi. Vendet që duan të anëtarësohen duhet të plotësojnë kritere të caktuara demokratike, ushtarake dhe ekonomike.

Përfitimet e anëtarësimit në NATO:

Anëtarësimi në NATO sjell një sërë përfitimesh, duke përfshirë sigurinë kolektive, mbështetjen për zhvillimin ekonomik dhe mundësitë për investime të huaja. Sondazhet tregojnë se mbështetja për anëtarësimin në NATO është e lartë në shumë vende që aspirojnë të bëhen pjesë e aleancës.

Përfundim:

Narrativat që përpiqen ta portretizojnë NATO-n si një forcë destabilizuese në Ballkan janë të pabazuara dhe kanë për qëllim të përhapin dezinformim dhe të nxisin përçarje dhe uljen e besimit të publikut tek aleanca. Roli i NATO-s në rajon ka qenë dhe mbetet i rëndësishëm për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit dhe anëtarësimi në aleancë është një vendim sovran i vendeve të rajonit.

Narrativa 6: SHBA-ja mund të mos i mbrojë aleatët e NATO-s që nuk shpenzojnë mjaftueshëm në mbrojtje.

Zyrtari i BE zbulon bisedën me Trump: NATO ka vdekur!

‘Nuk do ju mbrojmë nga Rusia’! Trump trondit aleatët e NATO-s

“Nuk të mbroj! Duhet të paguash!”- Trump bën deklaratën e papritur: Do inkurajojë Rusinë të sulmojë çdo aleatë të NATO-s që nuk kryen detyrimet

Përshkrimi i narrativës:

Narrativa që paraqet një braktisje nga ana e NATO-s të anëtareve të saj në rast se sulmohen është përhapur përmes titujve identikë nga të paktën 20 portale shqiptare në periudhën janar-shkurt 2024. Paraprakisht, ato qarkulluan masivisht edhe në mediat kryesore ndërkombëtare. “NATO-ja ka vdekur”, zyrtari i BE-së zbulon bisedën me Trump: “Më tha se nëse Evropa sulmohet, SHBA-ja nuk do të ndërhyjë”, është titulli që haset në thuajse të gjitha raportimet e publikuara në mesin e janarit 2024 dhe të monitoruara si pjesë e këtij studimi në portalet shqiptare. Në shkurt 2024, u ricikluan thuajse të njëjtët tituj dhe përmbajtje që përhapnin panik, këtë herë duke cituar në ligjëratë të drejtë kandidatin republikan për president, Donald Trump, përmes titujve bombastikë si: “SHBA-ja s’mund të mbrojë shtetet që nuk shpenzojnë për mbrojtje”, “Trump ‘shkund’ aleatët e NATO-s”. Kjo narrativë përhap idenë e

zhbërjes së unitetit të NATO-s dhe, madje, e paraqet në shumicën e rasteve si një relik të së kaluarës. Përhapja e kësaj narrative synon ta portretizojë NATO-n si një aleancë të pavlerë dhe të paaftë për të kryer misionin e saj për ruajtjen e paqes, ndërsa i mëshon përçarjes së aleancës si vendimmarrje e SHBA-së. Vlen të theksohet se narrativa NATO-ja ka vdekur, NATO-ja relik i së shkuarës apo e Luftës së Ftohtë, është pjesë e retorikës së zyrtarëve rusë Vladimir Putin e Sergey Lavrov.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt përmbajnë deklarata pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Donald Trump, ish-president dhe kandidat për president i SHBA-së:

“Nuk do t’ju mbroj. Në fakt, do ta inkurajoj [Rusinë] të bëjë çfarë dreqin do. Duhet të paguani. Duhet të paguani faturat.”

Aktorët që shpërndajnë narrativën: Media ndërkombëtare të cilat citojnë zyrtarë të BE-së dhe Donald Trump, Vladimir Putin, Sergey Lavrov.

Zbërthimi i narrativës:

Deklarata e artikuluar nga ish-presidenti Trump se SHBA-ja nuk do t’i mbrojë aleatët në rast sulmi është çorientuese dhe dezinformuese dhe përhap panik. Ajo është bërë në kontekstin e një takimi elektoral të mbajtur prej tij në SHBA në janar 2024, por është përhapur në media si një qëndrim që përfaqëson SHBA-në. Kjo deklaratë është konsideruar si e rrezikshme nga Shtëpia e Bardhë, ndërsa NATO-ja zyrtarisht është shprehur se SHBA-ja do të mbetet një aleat

i fortë dhe i përkushtuar i NATO-s.

Pretendimi i Trump se do të braktisë shtetet anëtare që nuk paguajnë i referohet një vendimi jo detyrues të NATO-s (vendosur në 2014) që çdo shtet anëtar të paguajë/investojë 2% të PBB-së në vit për mbrojtjen. Mospagimi i kësaj shume nuk e përjashton asnjë aleat nga ndihma kolektive e NATO-s në rast sulmi, çka përcaktohet qartë në Nenin 5 ku shkruhet se nëse një shtet anëtar i NATO-s është viktimë e një sulmi të armatosur, çdo anëtar tjetër i Aleancës do ta konsiderojë këtë akt dhune si një sulm të armatosur kundër të gjithë anëtarëve dhe do të ndërmarrë veprimet që i konsideron të nevojshme për të ndihmuar aleatin e sulmuar.

Edhe pjesa tjetër e narrativës se NATO-ja ka vdekur apo NATO-ja është një relik i së kaluarës, është e pavërtetë, madje, i përket narrativave të ricikluara nga Kremli për të përçmuar rolin e NATO-s, sidomos pas nisjes së sulmit në shkallë të plotë të Rusisë ndaj Ukrainës në shkurt 2022, ku NATO-ja cilësohet edhe si relik i Luftës së Ftohtë. Faktet e rrëzojnë këtë narrativë. Që prej samitit të Londrës në 1990, kur udhëheqësit e shteteve aleate u angazhuan “Të vazhdojnë të qëndrojnë së bashku, për t’ia zgjatur jetëgjatësinë paqes”, NATO-ja është shtuar me 13 anëtarë të rinj që prej asaj kohe. Ajo vijon të ruajë karakterin mbrojtës kolektiv bazuar në misionin e saj.

Narrativa 7: Lufta e Izraelit në rripin e Gazës tregoi dështimin e Perëndimit, i cili nxit islamofobinë dhe fyen myslimanët

Putin akuza SHBA dhe jep 'recetën' për zgjidhjen e situatës: Konflikti Izrael-Gaza shfaq dështimin amerikan në Lindjen e Mesme

Bota

Erdogani akuzon Perëndimin për "barbarizëm" dhe islamofobi në luftën në Gazë

Erdogan: Do i mësojmë perëndimorët arrogantë se fyerja e myslimanëve s'është liri mendimi

Përshkrimi i narrativës:

Në kontekstin e narrativës së madhe se Perëndimi, NATO-ja dhe BE-ja kanë dështuar dhe po çojnë vendet/botën drejt luftës, shfaqet dhe një nënkategori e saj që lidhet me konfliktin Izrael-Hamas. Pas 7 tetorit 2023, ku u shënua pengmarrja dhe vrasja e qytetarëve izraelitë, në median pro-ruse dhe më pas në ato ndërkombëtare, në mënyrë të përsëritur, i bëhet jehonë dështimit të Perëndimit për arritjen e paqes. Kësaj narrative i janë veshur edhe mesazhe që e përforcojnë idenë e dështimit, si për shembull se Perëndimi nxit islamofobinë dhe fyen myslimanët. Në median shqiptare nënkategoria e narrativës shfaqet në të paktën 16 tituj, ku spikasin deklaratat e dy aktorëve, Vladimir Putin dhe Recep Tayyip Erdogan.

Përgjithësisht, artikujt mbajnë në titull qëndrimin kundër Perëndimit që shprehin aktorët Putin, Erdogan, Lavrov, ndërsa përmbajtja i referohet burimeve si Radio Evropa e Lirë apo media të tjera ndërkombëtare. Në përmbajtje janë përfshirë deklaratat e aktorëve që përhapin këtë narrativë dhe mesazhet anti-BE, SHBA, NATO.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— Mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt përmbajnë deklarata nga zyrtarë të huaj pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Vladimir Putin, President i Federatës Ruse:

“Mendoj se shumë njerëz do të pajtoheshin me mua se ky është një shembull i qartë i dështimit të politikës amerikane në Lindjen e Mesme.”

— Aktorët që shpërndajnë narrativën: Vladimir Putin, Sergey Lavrov, Recep Tayyip Erdogan

Zbërthimi i narrativës:

Narrativa se Perëndimi, SHBA-ja, BE-ja apo NATO-ja kanë dështuar në arritjen e paqes gjatë konflikteve dhe konkretisht në Lindjen e Mesme është e pabazuar në fakte. Kjo narrativë dezinformuese, madje, heq edhe paralele me luftën në Ukrainë, për të cilën Rusia akuzon Perëndimin si shkaktar si dhe pengues në arritjen e paqes. Pjesë e kësaj narrative janë edhe përdorimi i mesazheve të pavërteta dhe që nxisin përçarje sidomos mes komuniteteve fetare dhe destabilitet, si për shembull: “Perëndimi po kryen barbarizëm, Perëndimi urren myslimanët, Perëndimi është islamofob”.

Në të vërtetë, BE-ja dhe SHBA-ja kanë advokuar vazhdimisht për arritjen e një zgjidhjeje paqësore mes Izrael-Palestinë ende para se të ndodhte sulmi i 7 tetorit 2023.

Ndër aktivitetet diplomatike që kanë nxitur zgjidhje paqësore mes palëve janë vizita e presidentit të SHBA-së Joe Biden në Palestinë në vitin 2022, ku ai bëri thirrje për rigjallërim të procesit të paqes, thirrje e përsëritur në vijim edhe gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me kryeministrin e Izraelit, Jair Lapid. Edhe pas sulmit, presidenti Biden deklaroi se si izraelitët ashtu edhe palestinezët meritojnë të jetojnë krah për krah në siguri, dinjitet dhe paqe. Ndërsa Sekretari Amerikan i Shtetit, Anthony Blinken, shprehu gjithashtu mbështetjen për paqen midis Izraelit dhe Palestinës gjatë vizitës së tij në Tel Aviv.

Në rrafshin e BE-së gjithashtu ka patur një angazhim diplomatik nga ana e unionit dhe liderëve të vendeve anëtare, si për shembull: Vizita e presidentit francez Macron në Izrael në tetor 2023, ku bëri thirrje për nisjen e procesit të paqes mes palëve, pjesëmarrja e ministres së jashtme gjermane Annalena Baerbock në samitin e paqes mbajtur në Kajro në tetor 2023, apo vizita e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë në Lindjen e Mesme në janar 2024. Ai theksoi angazhimin e BE-së për një zgjidhje mes dy shteteve dhe rëndësinë e rifillimit të dialogut midis Izraelit dhe Palestinës.

Narrativa 8: Bombardimet “brutale” të NATO-s në Serbi në shkelje të ligjit ndërkombëtar

Filmi > Dajç

“U shkel ligji ndërkombëtar”, Serbia dhe Rusia kërkojnë të ‘lajnë hesapet’ me NATO-n: Duam seancë në OKB

Lavrov: Perëndimi s’do të kënaqej me asgjë tjetër veçse ta ndante Kosovën nga Serbia

Bombardimet e NATO-s, Rusia e Serbia duan seancë në OKB: U shkel ligji ndërkombëtar

Përshkrimi i narrativës:

Një narrativë e ricikluar nga aktorët kundërshtarë është pretendimi se NATO-ja në vitin 1999 kreu agresion ndaj Serbisë duke shkelur ligjin ndërkombëtar me bombardimin e Serbisë dhe ia mori Kosovën asaj pa referendum.

Kjo narrativë gjeti hapësirë në portalet shqiptare në formën e raportimit në të paktën 15 raste të identifikuara në periudhën e marrë në studim. Përhapja e kësaj narrative përkon me evente ndërkombëtare që marrin gjithnjë vëmendje, Asambleja e OKB-së në Nju-Jork (mars 2024) dhe samiti i OSBE-së që u mbajt në Maqedoninë e Veriut (nëntor 2023). Shumica e portaleve kanë raportuar në tituj pretendimin e Rusisë se NATO-ja shkeli ligjin ndërkombëtar dhe injoroi kërkesat e Serbisë. Ky pretendim u artikulua në të dy eventet nga ministri i jashtëm rus Sergei Lavrov, por i është bërë jehonë në mënyrë të përsëritur edhe nga aktorë të tjerë si presidenti serb Aleksandër Vuçiç, ministri Ivica Daçiç dhe aktorë të tjerë pro-rusë në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt përmbajnë deklarata nga zyrtarë të huaj pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Vladimir Putin, Presidenti i Federatë Ruse:

“Ajo që bëri Perëndimi ishte krejtësisht e papranueshme. Pa asnjë rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ata filluan drejtpërdrejt një operacion ushtarak, një luftë në qendër të Evropës dhe me bombardimin e kryeqytetit të Jugosllavisë, Beogradit.”

Aktorët që shpërndajnë narrativën: Sergey Lavrov, Ivica Daçiç, Aleksandër Vuçiç, Vladimir Putin

Zbërthimi i narrativës:

Pretendimi i Rusisë se bombardimet e NATO-s shkelën ligjin ndërkombëtar janë false. Ato synojnë të diskreditojnë rolin mbrojtës dhe paqeruajtës të NATO-s dhe të krijojnë ndasi etnike në rajonin e Ballkanit Perëndimor duke ndikuar emocionalisht në komunitete të prekura nga lufta. Një tipar i rëndësishëm i këtyre narrativave është se ato ricklohen në kohë dhe vende specifike, konkretisht pas nisjes së luftës në Ukrainë, dhe artikulojnë në rajonin e Ballkanit Perëndimor ku ekzistojnë tashmë tensionet etnike të nxitura nga dezinformimi rus.

E vërteta është se operacioni i NATO-s për Kosovën ndodhi pas më shumë se një vit përpjekjesh intensive, por të pasuksesshme të OKB-së dhe Grupit të Kontaktit, (anëtare e të cilit ishte Rusia) për të sjellë një zgjidhje paqësore. Këshilli i Sigurimit i OKB-së në disa raste identifikoi spastrimin etnik në Kosovë dhe numrin në rritje të refugjatëve të dëbuar nga shtëpitë e tyre si kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Operacioni i Forcave Aleate të NATO-s nisi për të parandaluar shkeljet në shkallë të gjerë dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut dhe vrasjen e qytetarëve të pafajshëm.

Pas kësaj fushate vijoi operacioni paqeruajtës i udhëhequr nga NATO-ja, KFOR-i, i cili fillimisht përfshinte edhe Rusinë, nën mandatin e OKB-së (rezoluta 1244), me qëllim garantimin e sigurisë dhe paqes në Kosovë.

Narrativa 9: NATO dhe BE po zgjerojnë qendrat e tyre kibernetike të orientuara për sulme ndaj Rusisë. Hapja e qendrës kibernetike në Shqipëri i shërben luftës hibride ndaj Rusisë

Fillimi > Bota

**“Planifikohen sulme kibernetike ndaj Moskës”,
Ministria e Jashtme ruse: NATO ka ndërtuar baza
në vendet fqinje**

Home > Kryesoret

**“Është kërcënim për Ballkanin”, Rusia:
NATO po hap në Shqipëri një qendër për
sulme hibride**

**Rusia: Qendra që u hap në Shqipëri do
kryejë sulme kibernetike ndaj nesh**

Përshkrimi i narrativës:

Narrativa se Shqipëria po bëhet pjesë e shteteve që kërcënojnë sulme hibride ndaj Rusisë u përhap gjatë muajit prill 2024 në të paktën 12 artikuj në portale dhe media të ndryshme në Shqipëri që citonin zëdhënësen e Ministrisë së

Jashtme të Rosisë, Maria Zakharova. Të gjithë titujt e artikujve të monitoruar paraqesin vetëm qëndrimin e Rosisë. Përmes zëdhënësës së Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova, Rusia imponon idenë se “kjo lëvizje sinjalizon shfaqjen e mundshme të një burimi tjetër kërcënimesh hibride në Ballkan, një zonë e njohur për përballjen me sfida të shumta të krijuara nga ndikimi Perëndimor”. Kjo narrativë përkoi me hapjen e qendrave të rëndësishme në Shqipëri, bazën ajrore të NATO-s në Kuçovë dhe qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Tiranë në mars-prill 2024. Ky qëndrim është vijim i narrativës së mëhershme të përhapur nga Kremli (pas sulmit në shkallë të plotë të Rosisë ndaj Ukrainës) se Perëndimi po nxit dhe investon në shtetet anëtare të NATO-s për sulme kibernetike ndaj Rosisë.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— **Mungesë filtrash redaktorialë:** Artikujt përmbajnë deklarata nga zyrtarë rusë pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme Ruse:

“Fokusi i qendrave të tilla kibernetike do të jetë në Rusi, e cila për Shtetet e Bashkuara është një nga kërcënimet kryesore për stabilitetin amerikan në sferën digjitale.”

— **Aktorët që shpërndajnë narrativën:** Maria Zakharova

Zbërthimi i narrativës:

Pretendimi se ngritja e strukturave për mbrojtjen në Shqipëri do të përdoren për të sulmuar Rusinë është i pabazuar në fakte dhe manipulues për opinionin publik. Ky pretendim, bashkë me atë se NATO-ja dhe aleatët e saj kërkojnë të

luftojnë Rusinë, synon të eklipsojë faktin e njohur botërisht se është Rusia ajo që ka nisur një luftë të paprovokuar ndaj Ukrainës, duke shkaktuar viktima dhe dëme si dhe duke vënë në rrezik sigurinë, sidomos në Evropë. Një element dallues i këtyre narrativave është përdorimi nga aktorët kundërshtarë (në këtë rast Rusia) i taktikave që nxisin përçarje dhe ndjenja nacionaliste/etnike, siç janë për shembull ndërhyrja e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, rusofobia, etj. për të shmangur vëmendjen nga e vërteta mbi shkaktarët e luftës dhe agresionit në Ukrainë.

Hapja e qendrave të sigurisë e inovacionit, bazave ushtarake të stërvitjes dhe vëzhgimit është në vijim të angazhimit për ruajtjen e paqes së vendeve aleate të NATO-s ndaj çdo lloj kërcënimi. Këto masa janë përforcuar me angazhimin dhe solidaritetin e të gjithë anëtarëve të saj që prej vitit 2014, vit kur Rusia nisi aneksimin e Krimesë dhe në vijim, pas shkurtit 2022, kur Rusia nisi ofensivën në shkallë të gjerë ndaj Ukrainës.

Narrativa 10: Në Ukraine luftojnë mercenarë nga Shqipëria, Kosova, Bosnje dhe Hercegovina

Rusia: Kemi vrarë 171 mercenarë nga Kosova dhe Shqipëria në Ukrainë

LISTA/ Rusia thotë se ka vrarë 171 mercenarë nga Kosova dhe Shqipëria, në Ukrainë

Rusia: Kemi vrarë 171 mercenarë nga Kosova dhe Shqipëria!

Përshkrimi i narrativës:

Narrativa e dërgimit të mercenarëve shqiptarë në Ukrainë për të luftuar kundër Rusisë u rikthye në mediat shqiptare në mars 2024 si një deklaratë e Ministrisë së Mbrojtjes së Rusisë. Narrativa e ricikluar përbën herën e tretë të shpërndarjes në mediat shqiptare që prej shkurtit 2022. Shtatë portale të identifikuar gjatë periudhës studimore kanë publikuar “copy-paste” titull dhe përmbajtje të bazuar tërësisht në deklaratën e Ministrisë së Mbrojtjes të Rusisë të shpërndarë në platformën X (ish-Twitter). Edhe pse mediat përmendin në përmbajtje se nuk ka prova bindëse për të dhënat që ofron burimi rus, shpërndahet informacioni ku Rusia pretendon se që prej nisjes së sulmit në shkurt 2022 vetëm nga Shqipëria janë dërguar 192 mercenarë nga të cilët gati gjysma, 87, janë vrarë nga Rusia. E njëjta narrative, me më pak të dhëna, u artikulua vetëm një ditë para nisjes së sulmit në shkallë të plotë të Rusisë ndaj Ukrainës nga ministri i jashtëm Lavrov dhe më pas u riciklua në formën e një fushate edhe në vijim.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— Mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt përmbajnë deklarata nga zyrtarë të huaj pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur kështu narrativën dezinformuese.

Ministria e Mbrojtjes e Federatës Ruse:

“Në listë, Rusia ka përfshirë edhe Kosovën e Shqipërinë me 191 dhe 192 mercenarë që pretendon se kanë shkuar për të luftuar në krah të Ukrainës.”

— Aktorët që shpërndajnë narrativën: Sergey Lavrov, Maria Zakharova, Ministria Ruse e Mbrojtjes

Zbërthimi i narrativës:

Narrativa e ricikluar nga Kremli zyrtar se shtete të ndryshme, përfshirë edhe Shqipërinë, kanë dërguar mercenarë për të luftuar kundër Rosisë në Ukrainë, janë të pabazuara në fakte. Në përpjekje për ta bërë sa më bindëse këtë narrativë, Rusia paraqet shifra mbi mercenarë që kanë shkuar dhe që janë eliminuar prej saj, por nuk jep asnjë të dhënë të qenësishme mbi burimet apo identitetin e mercenarëve dhe viktimave të prezumuara mes tyre. Përmes kësaj narrative jepet ideja se mercenarët janë dërguar përgjithësisht nga shtete anëtare të NATO-s apo që aspirojnë të bëhen anëtare, duke vënë kështu në dyshim edhe integritetin dhe ligjshmërinë e tyre. Nga ana tjetër synohet të viktimizohet Rusia se po sulmohet, veç të tjerash, edhe nga mercenarë dhe se kjo e detyron atë të reagojë.

Në të vërtetë, Shqipëria ka reaguar zyrtarisht përmes institucioneve qeveritare duke përgënjeshtuar pretendimet e Rosisë, të cilat rezultojnë të jenë dezinformuese edhe nga verifikimet e kontrolluesve të fakteve.

Gjatë periudhës të monitorimit të medias, autorët e këtij studimi zbuluan 216 artikuj që përmbanin narrativa kundër Bashkimit Evropian në media shqiptare. Nga monitorimi dhe analizimi i artikujve që përmbajnë narrativa me tone anti-BE vëmë re se shpesh ato përqendrohen në disa kategori kryesore që synojnë të diskreditojnë Bashkimin Evropian dhe partnerët e tij. Një nga narrativat e përhapura është se BE-ja po shkel lirinë e shtypit me mbylljen e transmetimeve të mediave ruse, duke u përpjekur kështu të censurojë zërat kritikë dhe të mbrojë interesat e saj. Kjo narrativë, e përhapur fillimisht nga mediat pro-ruse si Tass dhe Ria Novosti, riprodhohet gjerësisht në portalet me numër të madh ndjekësish në Shqipëri dhe që kanë një qasje politike populiste. Një tjetër narrativë e përhapur e portretizon BE-në si një forcë shtypëse dhe shfrytëzuese të shteteve të tjera. Edhe narrativa se BE-ja dhe liderët e saj, së bashku me SHBA-në, nxisin luftën në Ukrainë dhe minojnë paqen në Evropë renditet ndër ato më të përhapurat, ku shënjestrohen kryesisht shtete si Polonia, Franca apo Gjermania. Artikujt që mbështesin këtë narrativë theksojnë se vendet e NATO-s dhe BE-së janë të përçara në qasjen e tyre ndaj Ruisë dhe financimit të ndihmës ushtarake për Ukrainën.

Një nga narrativat anti-BE të shpërndara shumë përfshin akuza se ajo po shantazhon Serbinë për sanksione ndaj Ruisë dhe se Serbia nuk trajtohet drejt nga Bashkimi Evropian. Kjo përpjekje për të nxitur përçarje midis vendeve të Ballkanit dhe BE-së është e dukshme në artikujt që theksojnë tensionet rreth sulmit së të Banjskës në Kosovë (ngjarje e shtatorit 2023) dhe reagimet jo të unifikuara të BE-së ndaj kësaj ngjarjeje. Po ashtu, në media shpesh përmenden pretendime se BE-ja është një forcë që cenon sovranitetin e vendeve anëtare duke u angazhuar në propagandë LGBTQ (me pretendimin se po shkatërrohen vlerat tradicionale të familjes dhe shoqërisë) kundër Hungarisë dhe duke injoruar zërin e fermerëve. Për më tepër, disa narrativa pretendojnë se Ukraina nuk është gati për hapjen e negociatave me BE-në dhe se anëtarësimi i saj në BE është një vendim i keq. Këto narrativa shfrytëzojnë ndjenjat anti-BE dhe skepticizmin rreth zgjerimit të unionit për të përhapur përçarje, por edhe për të dekurajuar vendet candidate, siç është Shqipëria, për t'u anëtarësuar.

Më poshtë po paraqesim 10 narrativat më të shpërndara kundër Bashkimit Evropian në median shqiptare gjatë periudhës së monitorimit.

Narrativa 1: Elitat evropiane kanë humbur identitetin kombëtar

Zemërimi i Putin dhe kërcënimi ogurzi i Lavrov: Dominimi botëror i Perëndimit do të përfundojë së shpejti!

Orban në Bruksel: Koha të ndryshojmë udhëheqjen “e keqe” të BE-së

Putin: Elitat evropiane kanë humbur identitetin kombëtar, janë të varura nga SHBA

Përshkrimi i narrativës:

Pretendimi i Ruisë dhe udhëheqësit populist të Hungarisë, Viktor Orban, spikat masivisht në raportimet që i referohen qëndrimeve zyrtare të këtyre aktorëve. Në të paktën 56 artikuj identifikohet përhapja e kësaj narrative, e cila përcjell mesazhe si: elitat evropiane nuk duan t’ia dinë për qytetarët e tyre, elitat evropiane i shërbejnë interesave të SHBA-së dhe janë kthyer në vasale të saj dhe se dominimi i tyre duhet të përfundojë njëherë e mirë. Artikujt që përcjellin këtë lloj narrative shfaqen te raportimet në lidhje me vendimmarrjen e BE-së mbi emigrantët, fermerët apo për luftën në Ukrainë. Përmbajtja e këtyre artikujve shpesh ka si burim mediat ndërkombëtare Reuters, AP, por vërehen edhe të tillë që u referohen burimeve shtetërore ruse, si Tass, Ria Novosti apo radio Kosuth në raportimet që i referohen liderit të Hungarisë, Viktor Orban. Edhe artikujt që përcjellin mesazhet e artikuluara nga Orban dhe Putin se partitë e djathta do tronditin elitat evropiane, apo se zgjedhja e Donald Trump si president i SHBA-së do të sjellë edhe paqen në Ukrainë, janë pjesë e kësaj narrative e cila është përhapur kryesisht para zgjedhjeve për Parlamentin Evropian të mbajtura në qershor 2024. Pjesë e kësaj narrative janë edhe mesazhet e Vladimir Putin mbi

domosdoshmërinë e zëvendësimit të elitave ekzistuese me një rend të ri botëror, mesazhe që artikulohe në evente të tilla si samitet Rusi-Afrikë apo takimet e liderëve rus me homologët e Kinës, Koresë së Veriut etj.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— **Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë:** Artikujt përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë dhe politikanëve populist evropian, pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur narrativa dezinformuese.

Viktor Orban, kryeministri i Hunagrisë

“Unë mendoj se liria në Evropë, dhe veçanërisht në Bruksel, është në rrezik, siç u tregua dje.

Pavarësisht nëse e quajmë komunizëm apo jo, ne po jetojmë në prag të shtypjes në Evropë.”

— **Aktorët që shpërndajnë narrativën:** Vladimir Putin, Viktor Orban, Sergey Lavrov, Peter Szijjarto

Zbërthimi i narrativës:

Kjo narrativë bazohet përgjithësisht në idenë se “elitat nuk duan t’ia dinë për njerëzit” dhe riciklohet si një mesazh me mjaft ndikim nga liderët populistë gjatë fushatave zgjedhore. Një parti ose kandidat, që pretendon se përfaqëson “zërin e popullit” ose “shumicën e heshtur”, e përdor këtë narrativë për të sulmuar establishmentin politik dhe u ofron votuesve zgjidhje të lehta për problemet komplekse. Kjo narrativë, që shpesh shfaqet edhe në formën e teorive të konspiracionit, mund të jetë e suksesshme pasi ofron një “kokë turku” për audiencën e targetuar, duke fajësuar për çdo problem apo situatë: politikanët, bankierët, korporatat e mëdha, hebrenjtë, oligarkët, myslimanët, burokratët e Brukselit, etj. Mediat dezinformuese ruse e shfrytëzuan shumë këtë narrativë në prag të referendumit të Brexit-it më 2016. Studues të fenomenit të dezinformimit gjykojnë se narrativa “elitat përballë njerëzve” ka një

histori gati njëshekullore të ekzistencës dhe përdorimit të saj.

Përhapësit e kësaj narrative pretendojnë se janë zëri i arsyes dhe se advokojnë për qytetarët e thjeshtë, duke u përplasur të vërtetën në fytyrë elitave që kërkojnë të fshehin «të vërtetën» me çdo kusht. “E vërteta” mund të lidhet me një shumëllojshmëri çështjesh, përfshirë migrimin, politikën dhe ekonominë; ndërkohë që elitat e veçanta që konsiderohen “fajtores” për fshehjen e së vërtetës janë zgjedhur në mënyrë strategjike për t’iu përshtatur ankesave të audiencës së targetuar. Si të gjitha narrativat e bazuara në teori konspirative, edhe narrativa “Elitat përballë njerëzve” kërkon t’i imponohet audiencës me pretendimet e veta mbi bazën e besimit dhe jo të faktit.

Narrativa 2: BE dhe SHBA po vjedhin asetet ruse për t’i përdorur për rindërtimin e Ukrainës.

Ndihma e BE-së për Kievin nuk do të ndryshojë rezultatit e luftës në Ukrainë

Perëndimi sekuestron asetet ruse, Lavrov akuza Gjermanisë: Të pabesë dhe hajdutë!

Rusia e kërcënon Perëndimin: Do të përgjigjemi ashpër, nëse konfiskohen asetet

Përshkrimi i narrativës:

Narrativa se BE-ja dhe SHBA-ja po vjedhin asetet e ngrira ruse kundër ligjeve ndërkombëtare për t'i përdorur për rindërtimin e Ukrainës është përhapur edhe në media shqiptare përmes të paktën 50 artikujve. Njësoj si edhe në përhapjen e narrativave të tjera kundër BE-së, artikujt identifikojnë që në titull këtë lloj pretendimi që rezulton të jetë artikuluar nga zyrtarë rusë. Frekuenca më e lartë e shpërndarjes së këtyre artikujve përkon me fushatën zgjedhore për Parlamentin Evropian, vendosjen e masave dhe sanksioneve shtesë ndaj Ruisë nga BE-ja apo samite të BE-së dhe ndërkombëtarëve për arritjen e paqes në Ukrainë. Këto lloj narrativash synojnë të dekurajojnë vijimin e mbështetjes ndaj Ukrainës të pushtuar në mënyrë të pajustificuar nga Rusia si dhe synojnë të diskreditojnë institucionet e BE-së si zhatëse të parave ruse dhe qytetarëve të BE-së, si dhe të portretizojnë Ukrainën si një shtet të korruptuar dhe që nuk meriton të mbështetet.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt citojnë zyrtarë rusë.

Dmitry Peskov, zëdhënës i Kremlinit:

“Si evropianët dhe amerikanët tashmë janë të vetëdijsëm për nivelin e korrupsionit (në Ukrainë) dhe e kuptojnë se një pjesë e konsiderueshme e këtyre parave po vidhet.”

Aktorët që shpërndajnë narrativën: Sergey Lavrov, Dmitry Peskov, Maria Zaharova

Zbërthimi i narrativës:

Kjo narrativë e përsëritur dezinformuese pro-Kremlinit që pretendon se “vjedhja” është motivi pas ngrirjes së aseteve ruse në Evropë është e pabazuar dhe synon të shtrembërojë perceptimin e opinionit publik.

Deri më sot, BE-ja ka vendosur 14 paketa sanksionesh ndaj Rusisë ku përfshihet edhe ngrirja e aseteve ruse në Evropë. Ngjashëm ka vepruar edhe SHBA-ja. Paketat e sanksioneve janë reagim i unionit pas sulmit të pajustificuar të Rusisë kundër Ukrainës me pasoja të rënda për ekonominë dhe jetën e qytetarëve. Propozimi i fundit i Komisionit Evropian sugjeron përdorimin e fondeve të ngrira ruse për të kompensuar Ukrainën për dëmin dhe shkatërrimin e shkaktuar nga pushtimi rus në territorin e saj. Kjo është thelbësore pasi forcat ruse dhe përfaqësuesit e tyre kanë sulmuar dhe kryer qëllimisht mizori kundër civilëve në Ukrainë. Ata shkatërroan gjithashtu infrastrukturën civile dhe kryen shkelje të tjera serioze të ligjit ndërkombëtar dhe humanitar. Në dritën e këtyre sulmeve, deputetët e Parlamentit Evropian e njohën Rusinë si një shtet sponsorizues të terrorizmit dhe si një shtet që “përdor mjetet e terrorizmit”.

Sipas propozimit të Komisionit Evropian, asetet ruse nuk do të konfiskohen përgjithmonë, por do t'i kthehen Rusisë nëse arrihet një marrëveshje paqeje, duke lejuar që ajo të përfshijë kompensimin për Ukrainën për dëmet që i ka shkaktuar.

Narrativa 3: Vendet e BE-së dhe NATO-s të përçara

Anëtari i NATO-s synon t'i bashkohet BRICS-it

Kryeministri i Hungarisë: Nuk duam të jemi pjesë e operacioneve të NATO-s në ndihmë të Ukrainës

Hungaria kërcënon Bullgarinë se mund t'i vë veto për hyrje në Schengen

Hungaria vendos veto ndaj rezolutës së KiE, nuk mbështetet formula e paqes e Ukrainës

Përshkrimi narrativës:

Narrativa se vende të BE-së dhe NATO-s janë të përçara në lidhje me vendimmarrjet mbi sanksionet ndaj Rusisë dhe ndihmën e Ukrainës kanë gjetur hapësirë domethënëse përmes 50 artikujve të publikuar në mediat online në Shqipëri gjatë periudhës së monitorimit. Nga këto, të paktën 11 artikuj të publikuar “copy paste” në portale të ndryshme flasin për veton e Hungarisë, vend anëtar i unionit, kundër hyrjes së Bullgarisë në hapësirën Schengen, nëse nuk heq taksën për kalimin e gazit rus që furnizon Hungarinë. Të gjithë artikujt citojnë ministrin e Jashtëm hungarez, Peter Szijarto, duke përhapur idenë se masat ndaj furnizimit me gaz nga Rusia janë diskriminuese. Ndërkohë, pjesa tjetër e artikujve që përhapin narrativën e përçarjes brenda BE-së dhe NATO-s citojnë aktorë të tjerë kundërshtarë si Viktor Orban, Maria Zakharova, Dmitry Peskov, etj, se BE-ja dhe NATO-ja janë të përçara edhe në lidhje me financimin e mëtejshëm të Ukrainës, sanksioneve ndaj Rusisë apo pjesëmarrjen në operacionet e NATO-s për Ukrainën. Narrativat kanë në thelb përhapjen e informacioneve të pavërteta se mungon dakordësia

mes bllokut të unionit të BE-së dhe aleatëve të NATO-s kur vjen fjala te vendimmarrja dhe politikat ndaj çështjeve që lidhen me luftën në Ukrainë.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt citojnë zyrtarë rusë dhe politikanë evropianë populistë.

Peter Szijarto, ministër i Jashtëm i Hungarisë:

“Ne e kemi bërë të qartë për bullgarët që, nëse e vazhdojnë këtë masë, nëse e dëmtojnë sigurinë e zinxhirit tonë furnizues, atëherë ne do ta përdorim veton për Schengen-in.”

— Aktorët që shpërndajnë narrativen: Viktor Orban, Maria Zakharova, Dmitry Peskov

Zbërthim i narrativës:

Narrativa “pro-Kremlin” se BE-ja (dhe NATO-ja) është e përçarë kur vjen fjala te vendosja e sanksioneve ndaj Rusisë apo mbështetja ndaj Ukrainës, rezulton të jetë shpërndarë edhe në mediat evropiane. Sipas gjetjeve të 3 organizatave ndërkombëtare kundër dezinformimit, janë 3 lloje narrativash të përshtatura sipas audiencave të ndryshme në lidhje me sanksionet ndaj Rusisë dhe përgjithësisht për vendimmarrjen e bllokut të BE-së. Për atë evropiane narrativa pro-Kremlin fokusohet te ndasia e anëtarëve ndaj vendosjes së sanksioneve (siç është çështja e gazit rus), për audiencën ruse kjo narrativë serviret në formën e lajmeve se sanksionet vetëm sa e kanë forcuar Rusinë, ndërsa për audiencën në Ukrainë narrativa sillet si informacion se sanksionet ndaj Rusisë nuk funksionojnë pasi Perëndimi është i shqetësuar për problemet e veta ekonomike dhe jo për Ukrainën. Të tria narrativat synojnë

përçarjen e vendeve të bllokut dhe heqjen e sanksioneve ndaj Kremlinit, gjë që do të forconte agresionin ndaj Ukrainës.

Në të vërtetë, as BE-së dhe as NATO-s nuk rezultojnë të kenë përçarje në lidhje me vendimmarrjet për sanksionet ndaj Ruisë dhe ofrimin e ndihmës ndaj NATO-s. E para ka miratuar 14 paketa sanksionesh ndaj Ruisë, të cilat e kanë dobësuar ekonomikisht këtë shtet në dy shtyllat kryesore të ekonomisë, eksportin e naftës dhe gazit. Më 18 dhjetor 2023, periudhë rreth së cilës rezultojnë të përhapura edhe këto narrativa, BE-ja vendosi të aplikojë paketën e 12-të të sanksioneve ndaj Ruisë me qëllim dobësimin e aftësive të saj për të financuar luftën kundër Ukrainës. BE-ja dhe NATO-ja i kanë vendosur qartësisht si kusht Ruisë të ndalojë pushtimin e Ukrainës. Edhe Hungaria, e cila sipas narrativave të përhapura i kundërvihet vendimmarrjeve të NATO-s dhe BE-së, në fund gjithmonë ka votuar në unitet me unionin.

Narrativa 4: Turqia do të braktisë rrugën evropiane, hedh sytë nga Rusia

“Rrugët e Turqisë me BE-në mund të ndahen” – Erdogan

“Nuk duhet të nënvlerësojmë Ruisë”, Erdogan bën avokatin e Putinit në OKB: Keni qasje negative ndaj tij

Çfarë e nervozoi presidentin turk? Erdogan shpërthen kundër Eurovizionit

Përshkrimi i narrativës:

Kjo është një narrativë e përhapur përmes 44 artikujve, përgjithësisht të publikuar “copy-paste” nga mediat shqiptare. Kryesisht, portalet citojnë në 30 artikuj presidentin turk Erdogan se “rrugët e Turqisë dhe BE-së mund të ndahen” dhe se “BE-ja nuk e mbajti premtimin dhënë Turqisë për pranimin e saj në union, ndërsa Turqia i ka mbajtur premtimet dhe ka kryer detyrimet e saj”. Frekuenca e artikujve me këtë narrativë është shënuar në dy periudha kryesore, shtator 2023 dhe tetor 2023, menjëherë pas publikimit të raportit të Parlamentit Evropian, në nisjen e sesionit të ri parlamentar në Turqi dhe gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork.

Megjithatë, disa prej artikujve që përforcojnë këtë narrativë janë shpërndarë edhe në periudha që përkojnë me mbajtjen e samitit të NATO-s apo eventin muzikor Eurosong. Artikuj që përforcojnë këtë narrativë janë ato që lidhen me kritikën e Erdogan ndaj Perëndimit (BE-së dhe NATO-s) se po tregohen të ashpër me Putinin (12 artikuj të identifikuar në këtë studim), apo me kritikën ndaj përmbajtjes së Eurosong dhe “përbaltjen e vlerave tradicionale” duke promovuar të drejtat e komunitetit LGBTQ. Vlen të theksohet se qëndrime të ngjashme përcillen edhe përmes artikujve që citojnë kryeministrin hungarez, Viktor Orban.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Mungesë konteksti: Lajmit i mungon konteksti dhe si rrjedhojë përmban tipare e një narrative përçarëse.

Recep Tayyip Erdogan, presidenti i Turqisë:

“BE-ja po përpiqet të shkëputet nga Turqia. Ne do të bëjmë vlerësimet tona kundër këtyre zhvillimeve dhe, nëse është e nevojshme, ne mund t’i themi BE-së se këtu rrugët tona ndahen.”

Aktorët që shpërndajnë narrativën: Recep Tayyip Erdogan, Viktor Orban

Zbërthim i narrativës:

Pavarësisht deklaratave dhe narrativave se Turqia do të braktisë kursin evropian apo edhe atë Perëndimor dhe po hedh sytë drejt Rusisë, nuk ka ndonjë vendimmarrje të tillë nga ana e saj. Pretendimi se BE-ja nuk e mbajti premtimin për pranimin e Turqisë në Union është i pabazuar në fakte. E vërteta është se prej hapjes së negociatave Turqi-BE kanë kaluar thuhetse 20 vjet. Megjithatë, vendi kandidat duhet të plotësojë dhe respektojë detyrimet që rrjedhin nga [Neni 49](#) dhe [Neni 2](#) i Traktatit të Bashkimit Evropian që janë përkatësisht:¹³

“Respektimi i dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës, respektimi i të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave dhe respekti për një shoqëri pluraliste dhe jo diskriminuese, për tolerancën, drejtësinë, solidaritetin dhe barazinë midis grave dhe burrave.”

Disa prej këtyre standardeve, siç ka deklaruar Përfaqësuesi i Lartë i BE-së në nëntor 2023, Joseph Borrel, dhe raporti i PE-së, nuk janë përmbushur nga Turqia.

Vlen të theksohet se narrativat që lidhen pikërisht me pakicat si refugjatët, komuniteti LGBTQ dhe grupe të tjera vulnerabël (për të cilat BE-ja ka vendosur kushte sa i përket respektimit të të drejtave) janë një element tipik i dezinformimit që vjen nga Kremli, i cili i targeton ato si “kërcënuese të vlerave tradicionale” dhe promovuese të degjenerimit të moralit dhe perversionit.¹⁴ Përmes kësaj narrative që rezulton të ketë depërtuar edhe në mediat shqiptare synohet të portretizohet BE-ja dhe Perëndimi si minus të këtyre vlerave, ndërsa Rusia si bartëse dhe mbrojtëse e vlerave tradicionale.

¹³ European Union. (2016). “Consolidated version of the Treaty on European Union [Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian]”. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12016M049>

¹⁴ EUvsDisinfo. (2022). “Key narratives in pro-Kremlin disinformation part 2: The ‘Threatened values’ [Narrativat kryesore në dezinformimin pro-Kremlin pjesa 2: “Vlerat e kërcënuara”]. <https://euvsdisinfo.eu/key-narratives-in-pro-kremlin-disinformation-part-2-the-threatened-values/>

Narrativa 5: Vendet e BE-së dhe NATO-s kanë dërguar trupa në Ukrainë të cilat luftojnë kundër Rusisë

“Brukseli luan me zjarrin”, Viktor Orban bën paralajmërimin e fortë: Perëndimi, një hap larg dërgimit të...

Rusia mund të përshkallëzojë luftën në Ukrainë nëse Perëndimi përfshihet drejtpërdrejt në konflikt

BOTA

Moska kërcënon Francën: Po dërgoi trupa në Ukrainë, përgjigja s’do të jetë politike

Përshkrimi i narrativës:

Pretendimi se ushtarë të shteteve anëtare të BE-së dhe NATO-s po luftojnë në terren në Ukrainë është përhapur vazhdimisht nga aktorët rusë si edhe ato pro-rusë të djathë si rasti i kryeministrit të Hungarisë, Viktor Orban. Në mediat shqiptare kjo lloj narrative (përforcuese e narrativës se të njëjtat vende dërgojnë edhe mercenarë në Ukrainë) shpërndahet përmes të paktën 40 artikujve, të cilat kanë si karakteristikë titullin me qëndrimin e zyrtarëve rus ose atij hungarez, se BE-ja ka dërguar ose do të dërgojë trupat ushtarake për të luftuar brenda territorit të Ukrainës. Një numër artikujsh citojnë zyrtarët rusë të cilët pretendojnë se vetë presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka konfirmuar dërgimin e trupave të NATO-s, ndërsa të tjerë artikuj citojnë në mënyrë të pasaktë ministrin e Jashtëm polak për të njëjtin pretendim. Bazuar në këtë narrativë, i mëshohet idesë se Rusia është e detyruar të reagojë ndaj këtij agresioni të vendeve të BE-së dhe NATO-s.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur narrativa dezinformuese.

Viktor Orban, kryeministri Hungarisë:

“Është një vorbull lufte që mund ta tërheqë Evropën në humnerë. Brukseli po luan me zjarrin.”

Aktorët që shpërndajnë narrativën: Vladimir Putin, Viktor Orban, Dmitry Peskov, Maria Zaharova, Artem Studenikov

Zbërthim i narrativës:

Pretendimet e Ruisë dhe aktorëve që e mbështesin atë se vendet e BE-së dhe NATO-s kanë dërguar trupa ushtarake për të luftuar në territorin e Ukrainës janë të pabazuara në fakte. Misioni i NATO-s, (ku bëjnë pjesë edhe shtetet anëtarë të Bashkimit Evropian), është mbrojtës dhe është krijuar i tillë që të mos provokojë konflikte, por t'i parandalojë ato. Aleanca ka përgjegjësinë të garantojë mospërshkallëzimin e luftës përtej Ukrainës, çka do të kishte pasoja shkatërruese dhe të rrezikshme. Siç deklarohet edhe zyrtarisht, NATO-ja ka shmangur mbylljen e hapësirave ajrore dhe dërgimin e trupave në Ukrainë për të shmangur një konflikt NATO-Rusi.

Edhe pretendimet se presidenti francez Macron dhe ministri i Jashtëm polak kanë konfirmuar dërgimin e trupave nga shtetet respektive për të luftuar në Ukrainë, kanë rezultuar narrativa të agjendës dezinformuese të Ruisë kundër BE-së dhe NATO-s për të justifikuar agresionin e saj ndaj Ukrainës dhe për të dekurajuar mbështetjen e Ukrainës në të drejtën e saj për t'u mbrojtur nga sulmi.

Narrativa 6: Anëtarësimi i Ukrainës në BE sjell katastrofë dhe kolapsin e Bashkimit Evropian

**Rusia: Anëtarësimi i Ukrainës në BE
dëmton gjithë sistemin e bllokut
evropian**

BOTA

**Orban: Hungaria ende mund të bllokojë procesin e
anëtarësimit të Ukrainës në BE**

Filimi > Bota

**Zëdhënësi i Kremlinit paralajmëron BE-në:
Anëtarësimi i Ukrainës do të çojë në kolaps...**

Përshkrimi i narrativës:

Anëtarësimi i Ukrainës në BE do të shkaktojë katastrofë dhe do të çojë në kolapsin e Bashkimit Evropian. Kjo narrative është përhapur përmes të paktën 30 artikujve në disa portale shqiptare në formën e deklaratave nga drejtues të shtetit rus, por edhe nga kreu i partisë së djathtë, Fidez, dhe njëkohësisht kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, i cili e quan një vendim të keq pranimin e Ukrainës në BE dhe se do të vërë veton kundër këtij vendimi. Përmbajtja e deklaratave dhe artikujve rezulton të jetë marrë nga agjenci lajmesh ruse ose agjenci të tjera ndërkombëtare, si radioja shtetërore hungareze. Këto deklarata, si për shembull ajo e zëdhënësit të qeverisë ruse, Dmitry Peskov, përhapin narrativën se anëtarësimi i një vendi si Ukraina në BE do të ishte një barrë për unionin që do rëndonte në kurrizin e shteteve anëtare dhe se ky anëtarësim do të sillte shpërbërjen e unionit.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt citojnë zëdhënësin e presidentit të Federatës Ruse.

Dmitry Peskov, zëdhënësi i Kremlinit:

“Anëtarësimi i Ukrainës në Bashkimin Evropian do të minojë të gjithë sistemin pan-evropian të bllokut dhe përfundimisht do të çojë në kolapsin e tij.”

Aktorët që shpërndajnë narrativën: Dimitry Peskov, Viktor Orban

Zbërthimi i narrativës

Narrativa se aderimi i Ukrainës në NATO është një vendim i keq dhe me pasojë kolapsin e unionit ka si qëllim të dekurajojë zgjerimin e BE-së dhe ofrimin e mbështetjes ndaj Ukrainës, e cila gjendet në luftën e paprovkuar prej saj me Rusinë. Pretendimet e pabazuara përhapen nga Rusia, e cila, deri tani, nuk ka treguar vullnet për arritjen e paqes dhe nga aktorë evropianë që mbështesin politikën e Ruisë. Në të vërtetë anëtarësimi i një vendi si Ukraina në BE sjell përfitime ekonomike për të dyja palët. Ukraina do të përfitojë nga investimet, ndihma dhe tregtia e lirë që ofron BE-ja, ndërsa BE-ja do të përfitojë nga pasuria e burimeve dhe tregu i ri i konsumatorëve. Anëtarësimi i Ukrainës mund të rrisë stabilitetin në rajon, ndërkohë që BE-ja ka mekanizma për të mbështetur vendet që janë në zhvillim, duke siguruar që çdo krizë të mund të menaxhohet pa rrezikuar qëndrueshmërinë e unionit.

Narrativa 7: Kosova provokon Serbinë pas sulmit në Banjskë. BE-ja nuk duhet të vendosë sanksione ndaj Serbisë

Hungaria, kundër Kosovës/ Orban e fajëson për provokime, qëndrim pro Serbisë

Orban merr në mbrojtje Serbinë: Sanksione? Kjo është qesharake dhe e pamundur

Sanksione nga BE për Serbinë? Orban mbron Vuçiç-in: Qesharake dhe e pamundur

Përshkrimi i narrativës:

Në më shumë se 20 artikuj që kanë qarkulluar në portalet shqiptare, përhapet narrativa se sulmi nga një grup i armatosur në manastirin e Banjskës, ku u vra një polic kosovar në shtator 2023, është reagim i serbëve ndaj provokimeve të Kosovës. Kjo narrative shpërndahet nga kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, i cili pretendon se Serbia nuk duhet t'i nënshtrohet sanksioneve të BE-së, sepse si viktimë e provokimeve të Kosovës ajo duhet të ndihmohet e jo të ndëshkohet. Kjo narrative gjen hapësirë sidomos në titujt e artikujve që citojnë Orban-in në ligjëratë të drejtë se vendosja e sanksioneve ndaj Serbisë është qesharake dhe e pamundur. Përmes kësaj narrative synohet të zvogëlohen përmasat e sulmit terrorist në Banjskë ku për më tepër u akuzua zyrtarisht numri dy i partisë Lista Serbe, Milan Radoičić si autor. Edhe pse përhapja e kësaj narrative nuk identifikohet si e qëllimshme nga ana e portaleve dhe mediave të marra në monitorim gjatë këtij studimi, janë disa element që e bëjnë të dëmshme përhapjen e saj.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

Mungesë konteksti: Raportimi i jep zë në mënyrë të njëanshme vetëm pretendimit të Viktor Orban, i cili njihet për qëndrimet pro-ruse dhe pro-serbe ndaj politikave denigruese ndaj Kosovës. Në thuajse të gjithë artikujt e identifikuar që kanë qarkulluar gati “copy-paste” ose me ndryshime jo thelbësore mungojnë burimet, duke u përqendruar vetëm te zbardhja dhe interpretimi i deklaratave të Viktor Orban dhe referenca për eventin ku është bërë deklarata, Samitin e Komunitetit Politik Evropian në Spanjë.

Raportimi nuk përfshin gjetjet dhe faktet që paraqet Kosova për të argumentuar përse i kërkon BE-së që të mbajë përgjegjëse Serbinë për këtë sulm. Gjithashtu mungojnë edhe fakte plotësuese që tregojnë se BE-ja ka vendosur sanksione ndaj Kosovës për precedent më pak të rëndë sesa sulmi i ndodhur në Banjskë. Nga mënyra se si është raportuar lajmi, gati “copy paste” në media të ndryshme, del në pah viktimizimi i Serbisë si shtet që provokohet dhe ndaj së cilës mund të merren masa padrejtësisht nga BE-ja.

Viktor Orban, kryeministri Hungarisë:

“Duhet të kuptoni se si sillet Kosova. Ata nuk duhet të provokojnë serbët.”

Aktorët që shpërndajnë narrativën: Viktor Orban

Zbërthimi i narrativës:

Sulmi në Banjskë, ku në shtator 2023 u vra pjesëtari FSK-së Afrim Bunjaku, ishte një akt i dhunshëm dhe terrorist, një incident që është dënuar nga komuniteti ndërkombëtar si një akt i rëndë dhune. Autoritetet kosovare kanë akuzuar dhe kanë kërkuar që Serbia të dorëzojë për gjykim numrin dy të partisë Lista Serbe, Radoiciç, si autor të këtij sulmi. Sa i përket pretendimit se Serbia është provokuar, nuk ka prova që të justifikojnë një sulm terrorist

ndaj një polici, siç është rasti në Banjskë. Sanksionet ndaj një shteti janë të bazuara në veprimet e tij dhe në ndjeshmërinë e situatës. BE-ja ka vendosur sanksione ndaj vendeve për incidente që janë më të lehta në krahasim me sulmin në Banjskë. BE-ja ka një praktikë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për të marrë masa ndaj veprimeve që janë në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar dhe normat e unionit.

Narrativa 8: Polonia ka pretendime territoriale ndaj Ukrainës dhe Bjellorusisë

Pas Ukrainës/ Putin kërcënon hapur shtetin tjetër europian: Nëse sulmoni Bjellorusinë do të...

Putin kërcënon Poloninë: Çdo agresion kundër Bjellorusisë është sulm ndaj Ruisë

“Pjesa perëndimore e Polonisë ishte dhuratë nga Stalini”, Putin: Nxjerr artilerinë e rëndë nëse sulmohet Bjellorusia

Përshkrimi i narrativës:

Pretendimi i makinerisë shtetërore të Kremlinit se Polonia, shteti fqinj me Ukrainën, kërkon të përfitojë territore, është një narrativë e përhapur fillimisht në mediat ndërkombëtare që ka gjetur pasqyrim edhe në mediat shqiptare. Nga monitorimi gjatë këtij studimi janë identifikuar të paktën 16 artikuj që citojnë presidentin Putin dhe zëdhënësin

e qeverisë ruse, Dmitry Peskov, me mesazhe si: “Polonia ka ambicie territoriale ndaj Ukrainës”, “Polonia ka dhuratë nga Stalini territoret e saj perëndimore që ishin toka gjermane” apo “Polonia ka qëllime të marrë territore të Bjellorusisë, por Rusia do të kundër përgjigjet me të gjitha mjetet”, etj. Narrativa është përhapur pas mbajtjes së samitit të vendeve të NATO-s, periudhë në të cilën Kremli shton retorikën e tij kundër seancës dhe mbështetësve të Ukrainës. Përmbajtja e artikujve të identifikuar citohet nga disa portale të jetë marrë nga mediat ndërkombëtare si REL, megjithatë disa prej tyre (media shqiptare) i kanë fryrë përmes titujve bombastike të narrativës së Kremlinit, si për shembull : “Pjesa perëndimore e Polonisë ishte dhuratë nga Stalini”, Putin: “Nxjerr artilerinë e rëndë nëse sulmohet Bjellorusia”.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt citojnë zyrtarë rusë dhe nuk kanë mjaftueshëm kontekst. Tituj bombastikë.

Vladimir Putin, presidenti Federatës Ruse:

“Dihet mirë se ata ëndërrojnë edhe tokën bjelloruse.”

— Aktorët që shpërndajnë narrativën: Vladimir Putin, Dmitry Peskov

Zbërthimi i narrativës:

Shënjestrimi i Polonisë nga dezinformimi i Ruisë lidhet me faktin se Polonia është një ndër mbështetëset kryesore të Ukrainës në luftën e paprovokuar ndaj saj të nisur nga Rusia. Një ndër taktikat dezinformuese të Kremlinit ndaj Polonisë është përdorja e marrëdhënieve të tensionuara dypalëshe Poloni-Bjellorusi prej 2020-ës për shkak të

politikës represive të presidentit Lukashenko. Marrëdhënia shënoi përkeqësim pas nisjes së sulmit në shkallë të plotë të Rusisë ndaj Ukrainës, ku Bjellorusia është përfshirë, ndër të tjera, edhe me ndihmën në armatim të Rusisë. Polonia, nga ana tjetër, i është bashkuar sanksioneve të BE-së kundër Rusisë dhe Bjellorusisë. Është pikërisht kjo situatë dhe evokimi i Bashkimit Sovjetik që Rusia e përdor në narrativat e saj për të portretizuar Poloninë si shtet mosmirënjohës, tradhtar dhe ekspansionist. Qëllimi i kësaj narrative është nxitja e destabilitetit dhe tensioneve si dhe dekurajimi apo trembja e vendeve që mbështesin Ukrainën se kjo qasje do të ketë pasoja. Polonia zyrtarisht mbështet qytetarët bjellorusë, duke respektuar nga ana tjetër si shtet anëtar i NATO-s dhe BE-së ligjin ndërkombëtar.

Narrativa 9: Ukraina nuk është shtet sovran, por protektorat i Perëndimit dhe kontrollohet nga një regjim nazist

“Ukraina nuk është më shtet sovran”-
Deklarata e fortë e kryeministrit të
Hungarisë: Ja kush është arsyeja e vërtetë e
luftës

Bota

Putin: 'Hebreu' Zelensky u vu në krye të Kievit për të
mbuluar nazizmin

Kryeministri hungarez: Ukraina nuk është më shtet sovran

Përshkrimi i narrativës:

Narrativa se Ukraina nuk gëzon sovranitet, por është një kukull në duart e Perëndimit për interesat e këtij të fundit, vjen sërisht si qëndrim i aktorëve kundërshtarë të Ruisë dhe kryeministrit të Hungarisë, Viktor Orban. Këto narrativa gjenden në rreth 16 artikuj të identifikuar në këtë studim dhe, ashtu si për narrativat e tjera të prezantuara, pretendimi vendoset që në titull.

Një pjesë e portaleve që kanë publikuar këta artikuj referojnë si burim mediat ndërkombëtare, si p.sh. “Associated Press”, ndërsa një pjesë tjetër nuk referojnë asnjë burim nga e kanë marrë lajmin. Pjesë e kësaj narrative bëhet edhe pretendimi nga të njëjtët aktorë se Ukraina është një shtet i korruptuar dhe se Perëndimi ka vendosur në krye të tij “hebreun Zelenski për të maskuar regjimin nazist në Ukrainë”. Artikujt i referohen si burim agjencisë ruse të lajmeve Ria Novosti, e cila njihet për përhapjen e këtyre narrativave jo vetëm përmes teksteve por edhe karikaturave.¹⁵

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

— Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë: Artikujt përmbajnë deklarata të zyrtarëve rusë pa shumë kontekst për lexuesin duke përhapur narrativa dezinformuese.

Viktor Orban, kryeministri Hungarisë:

“Ukraina nuk është më shtet sovran. Ukraina tani është vetëm protektorati i Perëndimit. Pra, pa paratë dhe armët nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, Ukraina si shtet do të pushonte së ekzistuari. Kështu që nuk është më një shtet sovran.”

— Aktorët që shpërndajnë narrativën: Vladimir Putin, Viktor Orban

¹⁵ EUvsDisinfo. (2019). “5 common pro-Kremlin disinformation narratives [5 narrativa të zakonshme të dezinformimit pro-Kremlin]”. <https://euvsdisinfo.eu/5-common-pro-kremlin-disinformation-narratives/>

Zbërthim i narrativës:

Pretendimi dezinformues, i artikuluar dhe shpërndarë nga aktorët kundërshtarë, se Ukraina është jo sovran dhe shtet-kukull në duart e Perëndimit, është i pabazuar në fakte. Kjo narrativë përsëritëse rezulton të jetë përhapur edhe gjatë aneksimit të pjesshëm të territoreve ukrainase nga Rusia në 2014-ën.

Përkundrazi, Ukraina njihet ndërkombëtarisht si një shtet sovran dhe asnjë shtet nuk e kontrollon atë. Marrëdhëniet BE-Ukrainë dhe SHBA-Ukrainë janë ngritur në bazë të parimit të barazisë, lirisë dhe pavarësisë. Në qershor 2014, BE-ja dhe Ukraina nënshkruan një Marrëveshje Asociimi, duke përfshirë një Zonë të Tregtisë së Lirë, të Thellë dhe Gjithëpërfshirëse (DCFTA), e cila promovon lidhje më të thella politike, ekonomike dhe respektimin e vlerave të përbashkëta.

Qeveria aktuale në Ukrainë u zgjodh në procesin e votimeve të mbajtura në vitin 2014, të cilat u njohën si të ligjshme dhe demokratike nga vëzhguesit. Zgjedhjet presidenciale, sipas raportit të ODIHR, ishin “kryesisht në përputhje me angazhimet ndërkombëtare dhe liritë themelore”.¹⁶

Vlen të theksohet se edhe pretendimi që Ukraina udhëhiqet nga ideologjia naziste është një tjetër narrativë e ricikluar nga Kremli që në 2013-2014, gjatë protestave të njohura si Euromaidan në Kiev. Rusia i ka portretizuar në mënyrë false këto ngjarje si grusht shteti të organizuar nga Perëndimi në Ukrainë. Këtë simbolikë makineria e dezinformimit rus e risjell shpesh për të targetuar BE-në dhe SHBA-në si organizatorë të protestave, apo grusht shteti në disa rajone, përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor duke sjellë si shembull Serbinë. Kjo narrativë është përdorur si justifikim nga Rusia për shkatërrimin e industrisë në Ukrainë, me pretendimin se kjo është një fushatë denazifikimi.¹⁷

¹⁶ ODIHR. (2014). “Monitoring Ukraine’s presidential election [Monitorimi i zgjedhjeve presidenciale në Ukrainë]”. <https://www.osce.org/odihr/elections/ukraine/121163>

¹⁷ EUvsDisinfo. (2024). “The denazification of Ukraine justifies the destruction of its industry [Denazifikimi i Ukrainës justifikon shkatërrimin e industrisë së saj]”. <https://euvsdisinfo.eu/report/the-denazification-of-ukraine-justifies-the-destruction-of-its-industry/>

Sa i përket narrativës së përhapur po nga Kremli se “Ukraina është një shtet i korruptuar”, shifrat e Transparency International tregojnë se perceptimi për korrupsionin në Rusi është më i lartë se ai në Ukrainë.¹⁸

Narrativa 10: Bashkimi Evropian po shkel lirinë e shtypit duke mbyllur transmetimet e mediave ruse

“BE, hipokrite”, aleati i Putinit hedh kritika: Nuk mund të ndalojnë mediat ruse, shkatërrojnë lirinë e shprehjes dhe shkelin të drejtën për informim

BE ndalon 4 media ruse. Moska: Europa është hipokrite!

Kryeparlamentari rus: BE-ja është hipokrite për ndalimin e mediave ruse

Përshkrimi i narrativës:

Një narrativë e përhapur nga qeveria ruse dhe mediat e saj është se Bashkimi Evropian po shkel lirinë e shtypit duke

¹⁸ Transparency International. (2021). “Corruption perception index [Indeksi i perceptimit të korrupsionit]”. <https://www.transparency.org/en/cpi/2021/index/ukr>

mbyllur transmetimet e mediave ruse. Kjo narrativë është përdorur për të viktimizuar Moskën dhe për të justifikuar veprimet e saj agresive, përfshirë pushtimin e Ukrainës.

Elementët tipikë të narrativës dezinformuese:

- **Viktimizimi i Moskës:** Artikujt përpiqen të paraqesin Rusinë si viktimë të një sulmi të padrejtë nga BE-ja që kufizon lirinë e saj të shprehjes.
- **Justifikimi i agresionit:** Narrativa përdoret për të justifikuar agresionin rus ndaj Ukrainës dhe për të legjitimuar veprimet e ardhshme ushtarake si përgjigje ndaj “sulmeve” perëndimore.
- **Termtat zhvlerësues:** Përdorimi i gjuhës që zhvlerëson rolin dhe rëndësinë e BE-së dhe Perëndimit, duke i paraqitur ato si agresorë të padrejtë.
- **Copy-Paste dhe mungesë filtrash redaktorialë:** Artikujt shpesh janë përkthyer dhe ripublikuar pa ndryshime të mëdha nga mediat shtetërore ruse si Tass, Ria Novosti, etj., në portale dhe media shqiptare.

Maria Zakharova, zëdhënësjja e Ministrisë së Jashtme ruse:

“Bashkimi Evropian po përdor lirinë e shtypit si një mjet për të shtrënguar lirinë e shprehjes dhe për të mbyllur zërat e pavarur që nuk përputhen me narrativat e tyre.”

- **Media Ruse:** Russia Today (RT), Sputnik, Tass

Zbërthimi i narrativës:

Narrativa se BE-ja po shkel lirinë e shtypit me mbylljen e mediave ruse është e pabazuar në fakte. Në të vërtetë, BE-ja ka vepruar për të kufizuar ndikimin e propagandës dhe dezinformimit që këto media shpërndajnë, sidomos në kontekstin e agresionit rus ndaj Ukrainës. Këto veprime janë në përputhje me politikën e BE-së për të mbrojtur integritetin informativ dhe sigurinë kombëtare të vendeve anëtare. Nga monitorimi gjatë këtij studimi janë identifikuar të paktën 10 artikuj.

Liria e Shtypit dhe Propaganda: Liria e shtypit është një e drejtë e rëndësishme, por ajo nuk përfshin lirinë për të shpërndarë propagandë dhe dezinformim. Mediat e kontrolluara nga shteti rus, si RT dhe Sputnik, janë identifikuar si mjete për përhapjen e narrativave që synojnë destabilizimin e vendeve perëndimore dhe justifikimin e veprimeve agresive të Rusisë.

Masat e BE-së: BE-ja ka marrë masa për të kufizuar transmetimin e mediave ruse si një mënyrë për të mbrojtur publikun nga propaganda dhe dezinformimi. Këto masa janë mbështetur nga vendime gjyqësore dhe procedura ligjore që synojnë të sigurojnë se veprimet janë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe lirinë e shtypit.

Përfundim: Narrativa që BE-ja po shkel lirinë e shtypit me mbylljen e mediave ruse është e pabazuar dhe synon të përhapë dezinformim dhe të nxisë përçarje. Veprimet e BE-së janë të drejtuara ndaj mbrojtjes së integritetit informativ dhe sigurisë kombëtare dhe nuk synojnë të kufizojnë lirinë e shprehjes, por të mbrojnë publikun nga dezinformimi dhe propaganda që mund të dëmtojë sigurinë dhe stabilitetin e rajonit.

Angazhimi me narrativat kundër NATO-s dhe BE-së

Përdorimi i medias sociale në Shqipëri ka shënuar një rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit, duke u bërë një nga mjetet kryesore të komunikimit dhe burimeve të informacionit për një pjesë të madhe të popullsisë. Platforma si Facebook, Instagram, TikTok dhe Twitter janë ndër më të përdorurat, sidomos të rinjtë, të cilët shfrytëzojnë këto kanale jo vetëm për të ndarë përvojat e tyre personale, por edhe për të ndjekur lajme dhe ngjarje të rëndësishme.

Kjo rritje e përdorimit të mediave sociale ka krijuar një terren pjellor për përhapjen e informacioneve të shpejta, por shpesh të pasakta apo të manipuluar.

Nga ana tjetër, njohuritë digjitale në Shqipëri mbeten relativisht të kufizuara, veçanërisht në kuptimin kritik të informacioneve që vijnë nga interneti dhe mediat sociale. Edhe pse shumë individë kanë akses të gjerë në teknologji, niveli i edukimit mediatic dhe digjital është i ulët. Kjo bën që përdoruesit shpesh të mos jenë të vetëdijshëm për rreziqet e dezinformimit dhe manipulimit online, si dhe për rëndësinë e verifikimit të burimeve të informacionit. Kjo mungesë e aftësive kritike për të dalluar burimet e besueshme nga ato të rreme ndikon në përhapjen e dezinformimit dhe teorive konspirative.

Media sociale gjithashtu ka ndryshuar mënyrën se si shqiptarët ndërveprojnë me lajmet dhe informacionin, me një tendencë rritjeje për konsumimin e lajmeve në formë të shkurtuar dhe të thjeshtuar. Artikujt dhe përmbajtja e mediave tradicionale shpesh ndahen dhe komentohen pa lexuar plotësisht, gjë që krijon një realitet ku informacionet keqinterpretohen ose përhapen në mënyrë të pasaktë. Në këtë mjedis digjital, aftësitë për të analizuar dhe përpunuar informacionin janë thelbësore, por mungesa e njohurive digjitale shpesh e pengon këtë proces.

Në një sondazh të opinionit publik të kryer nga BIRN Albania dhe IDRA Research në prill 2023, 76% e popullsisë deklaroi se dezinformimi është një shqetësim në Shqipëri, me 45% të të anketuarve që thanë se hasin dezinformim të paktën një herë në ditë, ndërsa 34% të tjerë se e hasin të paktën një herë në javë. Përdoruesit e mediave sociale dhe politikanët shqiptarë u identifikuan si burimet kryesore për përhapjen e dezinformimit, ndërkohë që media dhe gazetarët u konsideruan nga më shumë se 90% e publikut si aktorët kryesorë që kanë përgjegjësi në luftimin e narrativave të dezinformimit. Për më tepër, të dhënat nga sondazhi treguan se më shumë se 50% e të anketuarve kanë lexuar ose diskutuar për teoritë konspirative që lidhen me pushtimin rus të Ukrainës.¹⁹

Nëpërmjet aplikacionit “Crowdtangle” të kompanisë Meta, autorët e këtij studimi mblodhën të dhëna rreth

¹⁹ BIRN Albania. (2024). “BIRN Albania and SCiDEV present studies on disinformation, propaganda and fake news [BIRN Albania dhe SCiDEV paraqesin studime mbi dezinformimin, propagandën dhe lajmet e rreme]”. <https://birn.eu.com/news-and-events/birn-albania-and-scidev-present-studies-on-disinformation-propaganda-and-fake-news/>

ndërveprimeve që lexuesit në mediat sociale patën me artikujt në mediat shqiptare, të cilët u identifikuan me përmbajtje dhe narrativa kundër NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Të gjithë shkrimet e identifikuarra (n=1263), të cilat përmbanin narrativa kundër NATO-s dhe BE-së nga aktorë të ndryshëm kundërshtarë, kanë regjistruar në total 16,938 ndërveprime (“likes”, “emoji” ose komente) në Facebook, ose mesatarisht 13 ndërveprime për shkrim.

Shuma e ndërveprimeve të regjistruara në shkrimet me narrativa kundër NATO-s dhe Bashkimit Evropian përbënin vetëm 0.1% të ndërveprimeve totale të mediave shqiptare që i kanë botuar ato gjatë periudhës së marrë në studim. Nga të dhënat e mbledhura nëpërmjet “Crowdtangle” për shkrimet me përmbajtje kundër NATO-s dhe BE-së, nuk regjistrohen raste “virale” ose të shpërndarjes së koordinuar.

Sipas të dhënave, narrativa me ndërveprimin më lartë është “kërcënimi i luftës bërthamore midis Rusisë dhe NATO-s”, ndërsa aktori kundërshtar me më shumë ndërveprime në “Facebook” është Vladimir Putin, i ndjekur nga Viktor Orban, Dmitry Peskov, Sergej Lavrov dhe Recep Tayyip Erdogan (shih Figure 2).

NDËRVEPRIME NË FACEBOOK




Figure 2: Aktorët që shpërndajnë kundër NATO-s dhe BE-së sipas angazhimeve në Facebook

Aktorët kundërshtarë

Në këtë studim identifikohen dhjetëra aktorë kundërshtarë, ku përfshihen liderë politikë dhe figura publike, të cilët kanë përdorur platforma të ndryshme për të përhapur narrativa që minojnë dhe diskreditojnë NATO-n dhe BE-në.

Duke përdorur strategji të ndryshme dhe propagandë, ata synojnë të përçajnë opinionin publik, të nxisin tensione politike dhe të ulin besimin në institucionet perëndimore. Taktikat e tyre dezinformuese përfshijnë përhapjen e

lajmeve të rreme, përdorimin e retorikës së ashpër dhe shfrytëzimin e ndjenjave nacionaliste dhe populiste për të fituar mbështetje.

Në total, të shpërndarë në 1,263 artikuj të publikuar, të cilat përmbanin narrativa kundër NATO-s dhe Bashkimit Evropian, arritëm të identifikonim 77 aktorët që shpërndajnë narrativa kundër NATO-s dhe BE-së në median shqiptare. Mesatarisht, çdo aktor armiqësor ose kundërshtar, i cili ka shpërndarë narrativa kundër NATO-s dhe Bashkimit Evropian, është cituar në 16 shkrime të botuara në median shqiptare. Shpërndarja sipas numri të shkrimeve për aktorë armiqësor/kundërshtarë shkon nga 1 shkrim në 294 shkrime. Gati 85% e aktorëve armiqësorë janë cituar në më pak se 10 shkrime me narrativa kundër NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Ndërkohë, vetëm 12 aktorët kryesorë armiqësorë kanë shpërndarë në total 1,070 shkrime me narrativa kundër Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Shpërndarja e shkrimeve midis tyre luhet nga një minimum prej 22, deri në një maksimum në 294.

Ky studim ka identifikuar si aktorë kryesorë të shpërndarjes së narrativave dezinformuese anti-NATO zyrtarë të lartë shtetërorë rusë, përfshirë edhe ushtarakë - për shkak të profilit që lidhet me aktivitetin e NATO-s, si edhe politikanë të shteteve të tjera me qasje pro-ruse.

Më poshtë përshkruhet lista e aktorëve kryesorë që kanë shpërndarë narrativa anti-NATO dhe anti-BE gjatë periudhës monitoruese:

Vladimir Putin: Rusia mbetet kundërshtarja kryesore strategjike e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe Bashkimit Evropian në Evropë dhe presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, nuk është kursyer në artikullimin e tij kundër Perëndimit. Të dhënat tregojnë që deklaratat e presidentit rus shpërndahen nga mediat shtetërore ruse, si Russia Today, agjencia Tass dhe Ria Novosti.²⁰

²⁰ U.S. Department of State. (2022). Vladimir Putin's historical disinformation [Dezinformimi historik i Vladimir Putinit]. "U.S. Department of State". <https://www.state.gov/disarming-disinformation/vladimir-putins-historical-disinformation/>

Edhe pse këto media janë të sanksionuara nga Bashkimi Evropian për shpërndarjen e dezinformimit rus dhe narrativave përçarëse kundër BE-së gjatë zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, ato shpesh përkthehen dhe qarkullohen edhe në mediat shqiptare.

President i Ruisë është në pushtet që nga viti 1999 dhe njihet për qeverisjen e tij autoritare dhe politikën e jashtme agresive. Putin ka qenë një figurë kryesore në përhapjen e dezinformimit kundër NATO-s dhe BE-së, duke përdorur mediat shtetërore dhe operacionet e fshehta për të ndikuar opinionin publik në vendet perëndimore.

Nga analiza e të dhënave rezulton se gjatë periudhës 1-vjeçare të marrë në analizë, në median shqiptare kanë qarkulluar 294 artikuj me narrativa kundër NATO-s dhe BE-së të cilat citojnë presidentin rus, Vladimir Putin, duke e renditur këtë të fundit si aktorin me riskun më të lartë.

Narrativa kryesore kundër NATO-s dhe Bashkimit Evropian e shpërndarë nga Vladimir Putin lidhet me kërcënimin e shpërthimit të një lufte bërthamore midis Ruisë dhe Perëndimit, për shkak të ndihmës që ky i fundit i jep Ukrainës. Gjithashtu, zgjerimi i NATO-s, ose atë që Rusia e paraqet si qasje agresive të NATO-s ndaj kufijve të saj, është një tjetër narrative e përhapur nga presidenti Vladimir Putin dhe zyrtarë të tjerë të Kremlinit të angazhuar në paraqitjen e NATO-s dhe BE-së si të rrezikshme për sigurinë.

Një variant tjetër i kësaj narrative të shpërndarë nga Vladimir Putin lidhet me kërcënimin e një Lufte të Tretë Botërore midis SHBA-së dhe vendeve të BE-së nga njëra anë dhe Ruisë dhe aleatëve të saj.

Shpesh kërcënimi i shpërthimit të luftës bërthamore lidhet me stërvitjet e forcave ushtarake dhe mjeteve bërthamore ruse, ose si paralajmërim kundër vendeve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian për të mos dërguar trupa në Ukrainë, siç është sugjeruar edhe në formë provokimi ndaj Ruisë nga disa liderë politikë evropianë, ku kryesori mes tyre është president Emanuel Macron.

Viktor Orban: Kryeministër i Hungarisë, lider i partisë së djathtë Fidesz, anëtare e Partive Popullore Evropiane, ka ndjekur politika populiste dhe anti-emigracion. Orban, i njohur për qëndrimin pro-Ruisë, marrëdhëniet e mira

me presidentin rus Vladimir Putin dhe kritik i ndihmës së Perëndimit ndaj Ukrainës, ka kritikuar BE-në dhe NATO-n duke u renditur mes politikanëve euroskeptikë. Ai ka përdorur media të kontrolluara nga qeveria për të përhapur narrativa kundër institucioneve perëndimore, sidomos BE-së dhe NATO-s. Në analizën tonë studimore identifikohen të paktën 220 artikuj të shpërndarë nga mediat shqiptare, sidomos ato me numër të lartë ndjekësish, ku citohet Viktor Orban me narrativat dezinformuese, duke u renditur i dyti pas presidentit rus Vladimir Putin në listën e 12 aktorëve kryesorë kundërshtarë.²¹

Narrativat kryesore të përhapura nga Orban janë: Anëtarësimi i Ukrainës në NATO do të shkaktojë Luftën e Tretë Botërore, dhënia e ndihmës me armatim nga Perëndimi për Ukrainën do të përshkallëzojnë konfliktin, BE-ja është e përçarë për çështjet e emigracionit në Evropë, BE-ja është e përçarë për sulmin e Banjskës dhe për sanksionet ndaj Serbisë, BE-ja kontrollohet nga George Soros, BE-ja po bën ofensivë ndaj Hungarisë me propagandën pro LGBTQ.

Këto narrativa dezinformuese rezultojnë të kenë një frekuencë të shtuar në periudhat para dhe gjatë zgjedhjeve lokale apo evropiane si dhe u pasuan me të tjera narrativa të ngjashme pasi Hungaria e udhëhequr nga Viktor Orban mori presidencën e radhës të BE-së, prej 1 korrikut 2024.

Më herët dhe pas marrjes së kryesimit të BE-së, një nga narrativat e përhapura nga Orban ishte propagandimi dhe vetëshpallja si misionar për arritjen e paqes në Ukrainë, duke zhvilluar takim edhe me presidentin Putin, një akt i kritikuar nga BE-ja sa kohë Putin ka një urdhërarresti ndërkombëtar për krime lufte ndaj Ukrainës.

Dmitry Peskov: Zëdhënës i Kremlinit dhe sekretar për shtypin i Vladimir Putin. Peskov është i njohur për rolin e tij në shpërndarjen e mesazheve dhe narrativave të Kremlinit, shpesh i duke përdorur për të minuar besimin e publikut te politikat e NATO-s dhe BE-së. Në periudhën 1 vjeçare që është marrë në studim, sa i përket përhapjes së narrativave nga 12 aktorët kryesorë kundërshtarë, Peskov rezulton si përhapës i dezinformimit në të paktën 166 artikuj të publikuar në portale të ndryshme shqiptare. Këto të fundit i referohen kryesisht mediave apo institucioneve

²¹ Political Capital. (2023, 13 qershor). The effects of Russian narratives in Europe: Challenges for the V4 [Efektet e narrativave ruse në Evropë: Sfida për V4]. "Political Capital". https://politicalcapital.hu/rendezvenyek.php?article_read=1&article_id=3289

shtetërore ruse (Tass, Sputnik, Ria Novosti) që shpërndajnë deklaratat e Peskov, propaganda e të cilit fokusohet në portretizimin e NATO-s si agresore dhe përgjegjëse për përshkallëzim të konfliktit në Ukrainë, apo NATO dhe Perëndimi kërcënim për sigurinë e Ruisë dhe rendin ndërkombëtar, anëtarësimi i Ukrainës në NATO do të sjellë reagimin e ashpër të Ruisë, Rusia do të hakmerret nëse asetet e bllokuara të saj do të përdoren për të armatosur Ukrainën, NATO-ja shkakton përkeqësimin e tensioneve mes Moskës dhe Perëndimit, si dhe Turqia nuk duhet të ketë iluzione për anëtarësimin në BE.²²

Nga analiza gjatë këtij studimi, bie në sy se përhapja e narrativave dezinformuese, përçarëse dhe nxitëse e urrejtjes dhe panikut përqendrohet në periudha të tilla si zgjedhjet për Parlamentin Evropian, samiti vjetor i NATO-s, samiti i paqes për Ukrainën.

Sergey Lavrov: Ministër i Punëve të Jashtme të Ruisë që nga viti 2004 dhe përkras i politikave të presidentit Putin, Lavrov është i njohur për retorikën e tij të ashpër dhe akuzat ndaj NATO-s dhe BE-së për ndërhyrje dhe destabilizim. Në deklaratat e shpeshta të publikuara nga mediat shtetërore ruse si Ria Novosti, Tass etj, si dhe nga faqet online të institucioneve shtetërore dhe përfaqësive diplomatike në vende të ndryshme, përfshirë edhe Shqipërinë, propagandohet legjitimimi i mësymjes së Ruisë ndaj Ukrainës. Shpesh Lavrov i ka mëshuar termit “Operacion special” të Ruisë ndaj Ukrainës, duke e justifikuar sulmin si të domosdoshëm. Në vazhdim të kësaj propagande, Lavrov, i ndihmuar nga makineria shtetërore ruse dhe mediat pro saj, ka përsëritur narrativa të tilla si mercenarë nga vende të Ballkanit Perëndimor si Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut janë dërguar në Ukrainë për të luftuar kundër Ruisë. Edhe pse këto deklarata, të shpërndara dhe ricikluara pa u verifikuar edhe nga vetë mediat shqiptare, janë të pabazuara në fakte, ato riciklohen rregullisht si pjesë e propagandës ruse për të treguar se Rusia është viktima dhe jo agresori.²³

²² U.S. Embassy in Luxembourg. (n.d.). Faces of Kremlin propaganda: Dimitri Peskov [Fytyrat e propagandës së Kremlinit: Dimitri Peskov]. “U.S. Embassy in Luxembourg”. <https://lu.usembassy.gov/faces-of-kremlin-propaganda-dimitri-peskov/>

²³ Dickinson, P. (2022, 2 maj). Lavrov’s anti-Semitic outburst exposes absurdity of Russia’s Nazi Ukraine claims [Shpërthimi antisemitik i Lavrovit ekspozon absurditetin e pretendimeve të Ruisë për Ukrainën naziste]. “Atlantic Council”. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/ukrainealert/lavrovs-anti-semitic-outburst-exposes-absurdity-of-russias-nazi-ukraine-claims/>

Sergey Lavrov identifikohet si aktor kundërshtar në studimin tonë në të paktën 116 artikuj të shpërndarë nga mediat shqiptare të cilat i referohen burimeve të tilla si agjencitë shtetërore ruse apo mediave ndërkombëtare, si dhe faqeve zyrtare të institucioneve ruse. Mes narrativave të shpërndara nga Lavrov mbizotërojnë ato që përçmojnë NATO-n, BE-në apo edhe organizma të tjera si OSBE-ja, duke nxitur dekurajimin dhe mungesën e besimit të publikut ndaj tyre. Gjithashtu narrativa që nxisin urrejtje etnike/nacionaliste dhe panik janë deklaratat e Lavrov që lidhen më Serbinë, e cila portretizohet si viktimë e politikave të padrejta të Perëndimit (duke evokuar rolin “shkatërrues” të NATO-s gjatë luftës në Kosovë), për shkak të marrëdhënieve miqësore që Serbia ruan me Rusinë. Narrativa më e rrezikshme dhe më shumë e përhapur nga Lavrov, në periudhën 1 vjeçare të marrë në studim, është se NATO-ja dhe BE-ja po bëhen shkaktare të një lufte bërthamore apo shpërthimit të Luftës së Tretë Botërore. Nuk mungojnë as narrativat përçarëse dhe që përhapin panik si: Perëndimi synon të armiqësojë vendet e Ballkanit Perëndimor mes njëri-tjetrit, Perëndimi mbjell kaos në Armeni, apo se është Perëndimi ai që po përshkallëzon konfliktin në Ukrainë. Edhe propaganda anti-Perëndim duke e portretizuar atë (Perëndimin dhe institucionet ndërkombëtare) si islamofob dhe nxitës të konfliktit Izrael-Hamas, bën pjesë në listën e narrativave dezinformuese të përhapura ose frymëzuara nga kryediplomati rus Lavrov.

Aleksander Vuçiç: President i Serbisë, lider i Partisë Progresive Serbe. Vuçiç ka ndjekur një politikë të balancuar midis BE-së dhe Rusisë, megjithatë, ai nuk i ka kursyer kritikën dhe kundërshtitë ndaj sanksionimit të Rusisë nga SHBA-ja dhe BE-ja, duke vijuar ndërkohë lidhjet ekonomike dhe ushtarake me Moskën.²⁴

Aleksandër Vuçiç identifikohet, sipas analizës së të dhënave në këtë studim, si një ndër përhapësit kryesorë të narrativave që paralajmërojnë shpërthimin e një lufte në Ballkan apo shpërthimin e një lufte globale. Ai bën shpesh thirrje për nevojën urgjente që sipas tij ka Serbia për forcimin e ushtrisë dhe shtimin e armatimit për të shmangur kështu sulmet që i kanosen Serbisë nga fqinjët dhe jo vetëm. Kjo narrative artikullohet prej tij në evente ushtarake

²⁴ ISAC Fund. (2023, 12 qershor). Analysis of the news: Vucic—We are exposed to the most direct threats, we will not fall for provocations [Analizë e lajmeve: Vuçiç—Ne jemi të ekspozuar ndaj kërcënimeve më të drejtpërdrejta, nuk do të biem në provokime]. “ISAC Fund”. <https://www.isac-fund.org/en/news/analysis-of-the-news-vucic-we-are-exposed-to-the-most-direct-threats-we-will-not-fall-for-provocations>

përmes deklaratave të tilla se Serbia po spiunohet me dronë nga vende fqinje si Shqipëria. Një prej narrativave kryesore të shpërndara prej tij është edhe portretizimi i Kosovës dhe udhëheqësve të saj si destabilizuese, shkelëse e të drejtave të serbëve që jetojnë në veriun e Kosovës dhe pamundësimin e një jetë normale nën autoritetet kosovare. Kjo narrative shoqëroi edhe zhvillimet pas ngjarjes së Banjškës, ku zyrtari i Listës Serbe u akuzua nga autoritetet e Kosovës për vrasjen e një polici të FSK-së.

Qasja e Vuçiç ndaj NATO-s dhe BE-së ndahet mes kritikave ndaj tyre (Perëndimit) për sanksionimet e Rusisë gjatë luftës në Ukrainë, por edhe nevojës së bashkëpunimit sa kohë forca të KFOR-it kryejnë detyrën në kufirin mes Kosovës dhe Serbisë, teksa kjo e fundit është kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Pavarësisht kësaj, Vuçiç ka përdorur mediat e kontrolluara nga qeveria për të përhapur narrativa kundër BE-së, duke theksuar trajtimin e padrejtë të Serbisë, sidomos në dialogun me Prishtinën, dhe duke promovuar jo rrallë një imazh të BE-së si një forcë destabilizuese në Ballkan. Të gjitha këto narrativa rezultojnë të riciklohen “copy-paste” nga mediat shqiptare me tituj sensacionalë.

Milorad Dodik: President i Republikës Srpska dhe lider i Aleancës së Social-Demokratëve të Pavarur (SNSD) në Bosnje dhe Hercegovinë. Dodik është një mbështetës i fortë i lidhjeve të ngushta me Rusinë dhe ka kundërshtuar politikat e BE-së dhe NATO-s në Ballkan. Ai njihet për deklaratat që nxisin urrejtjen etnike, përçarjen dhe armiqësimin duke propaganduar narrativa të tilla si: Gjenocidi i Srebrenicës nuk ekziston, Do të ketë ndryshim të dhunshëm të kufijve në Ballkanin Perëndimor dhe Republika Srpska do të shkëputet nga Bosnja për t’iu bashkuar Serbisë. Këto narrativa, bazuar në analizën tonë, përkojnë me evente të tilla si mbajtja e kuvendit gjithë-serb, krishtlindjen ortodokse apo asambleja e OKB-së ku u votua për shpalljen e 11 korrikut (referuar 11 korrikut të vitit 1995 në Bosnje dhe Hercegovinë, ku u vranë më shumë se 8,000 boshnjakë myslimanë, kryesisht burra dhe djem të moshës 12 deri 77 vjeç) si Dita Ndërkombëtare e Gjenocidit.²⁵

²⁵ International Press Institute. (2023, 1 gusht). Analysis: Backsliding in Bosnia and Herzegovina as media freedom faces myriad challenges [Analizë: Prapësimi në Bosnjë dhe Hercegovinë ndërsa liria e medias përballlet me sfida të shumta]. “International Press Institute”. <https://ipi.media/analysis-backsliding-in-bosnia-and-herzegovina-as-media-freedom-faces-myriad-challenges/>

Dodik përdor mediat e kontrolluara nga qeveria, si RTRS dhe platforma të tjera, për të përhapur mesazhe që përforcojnë skepticizmin ndaj institucioneve perëndimore dhe përhapin panik për destabilizim të situatës në Ballkan.

Nga analiza e të dhënave rezulton se gjatë periudhës 1-vjeçare të marrë në analizë, në median shqiptare kanë qarkulluar 8 artikuj me narrativa kundër NATO-s dhe BE-së-së të cilat citojnë kreun e Republikës Srpska të Bosnjës dhe Hercegovinës, Miorad Dodik.

Maria Zakharova: Zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme të Rusisë. Zakharova është një nga figurat kryesore në përhapjen e dezinformimit rus, shpesh duke akuzuar NATO-n dhe BE-në për agresion dhe manipulim politik.²⁶ Ashtu si edhe për zyrtarët e tjerë rusë edhe deklaratat e Maria Zakharovës shpërndahen nga mediat shtetërore ruse dhe faqet zyrtare online të institucioneve shtetërore të Rusisë. Më pas ato merren dhe riciklohen shpesh “copy-paste” edhe nga mediat shqiptare. E tillë ishte, për shembull, deklarata e Zakharovës në prill 2024, shpërndarë përveç mediave ruse edhe nga faqja e ambasadës ruse në Tiranë, pas përrurimit të Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Tiranë. Ky event që pasonte hapjen e bazës ajrore të NATO-s në Kuçovë, u etiketua si kërcënim hibrid ndaj Rusisë nga ana e NATO-s.

“Zgjerimi i qendrave kibernetike nëpër rajone të ndryshme është në vazhdim. NATO-ja po planifikon aktualisht të krijojë një strukturë të ngjashme në Shqipëri. Kjo lëvizje sinjalizon shfaqjen e mundshme të një burimi tjetër kërcënimesh hibride në Ballkan, një zonë e njohur për përballjen me sfida të shumta të krijuara nga ndikimi perëndimor”, ishte reagimi i zëdhënëses Zakharova.

Pjesë e këtyre narrativave janë edhe ato që shenjestrojnë NATO-n si ndjekëse e politikave ekspansioniste dhe provokuese, marrë shkas nga stërvitja e përbashkët e NATO-s në Finlandë. Edhe deklaratat në sintoni me zyrtarët e tjerë të qeverisë ruse përhapin të njëjtat narrativa se trupat e NATO-s në Ukrainë rrezikojnë sigurinë e Rusisë, Ukraina dhe NATO-ja trafikojnë organe njerëzore në tregun e zi, Perëndimi fshihet pas organizimit të protestave në

²⁶ U.S. Department of State. (2023). Faces of Kremlin propaganda: Maria Zakharova [Fytyrat e propagandës së Kremlinit: Maria Zakharova]. “U.S. Department of State”. <https://www.state.gov/faces-of-kremlin-propaganda-maria-zakharova/>

Beograd, apo BE-ja shkel lirinë e shtypit përmes pezullimit të funksionimit për katër media të lidhura me Rusinë në territorin e bllokut evropian. Analiza studimore në harkun kohor maj 2023-2024 tregoi se në median shqiptare kanë qarkulluar të paktën 106 artikuj me narrativa kundër NATO-s dhe BE-së-së të cilat citojnë zëdhënësen e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakarova.

Recep Tayyip Erdogan: President i Turqisë që nga viti 2014. Erdogan ka ndjekur një politikë të jashtme të pavarur dhe shpesh ka pasur tensione me NATO-n dhe BE-në. Edhe pse një vend anëtar i NATO-s prej 1952 dhe vend kandidat për në Bashkimin Evropian prej disa dekadash me negociatat e hapura në vitin 2005, por që mbetën në vend në 2016-ën, Turqia shpesh mban një pozicion kritik ndaj këtyre dy entiteteve. Presidenti Erdogan, i kritikuar nga BE-ja për shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirisë së shprehjes, njihet për qëndrimet kundërshtuese ndaj BE-së sidomos pas tentativës për grusht shteti verën e vitit 2016. Media shtetërore turke si Anadolu etj, shpesh kanë shpërndarë narrativa që shenjestrojnë institucione ndërkombëtare evropiane dhe perëndimore ndaj personave të akuzuar prej Erdogan-it si bashkëpunëtorë në grushtin e shtetit, apo gazetarë që kritikojnë udhëheqjen e tij. Mediat shqiptare kanë publikuar rregullisht edhe narrativat e shpërndara prej Erdogan-it ku ai ushtron presion që Shqipëria të mbyllë institucionet fetare, kulturore, arsimore të sponsorizuara nga krahu i gyenistëve si dhe arrestimin dhe dërgimin e tyre në Turqi për t'u përballur me drejtësinë.²⁷

Në analizën e të dhënave të këtij studimi janë identifikuar 68 artikuj të publikuar në mediat shqiptare, ku narrativat më të përhapura lidhen me pretendimin e Erdogan se BE-ja nuk i ka përmbushur zotimet ndaj Turqisë, se BE-ja është shkak i ngecjes së negociatave për anëtarësimin e Turqisë në Union, gjë e cila ka ndikuar që Turqia të hedhë sytë nga aleancat me Rusinë, Kinën, Iranin dhe aderimin në organizatën BRICS.

Këto narrativa janë përforcuar sidomos gjatë dhe pas pandemisë së Covid-19 dhe janë intensifikuar me shpërthimin e konfliktit në Gazë, për të cilin Erdogan citohet si akuzues ndaj SHBA-së dhe Perëndimit për barbarizëm dhe

²⁷ Sloat, A. (2023, 15 shtator). Recep Tayyip Erdoğan, Elon Musk, and Twitter's social media power [Recep Tayyip Erdoğan, Elon Musk, dhe fuqia e rrjeteve sociale në Twitter]. "Politico". <https://www.politico.eu/article/recep-tayyip-erdogan-elon-musk-twitter-turkey-elections-social-media-power/>

islamofobi. Ai ka përdorur mediat për të përhapur narrativa që kritikojnë dhe minojnë këto institucione, narrativa që riciklohen rregullisht edhe nga mediat shqiptare.

Dmitry Medvedev: Ish-president dhe kryeministër i Rusisë, njihet gjithashtu për artikullimin konstant dhe shpërndarjen e narrativave që shënjestrojnë NATO-n dhe BE-në si armike të Rusisë, me qëllime të qarta ekspansioniste dhe imperialiste.²⁸

Aktualisht, nënkryetar i Këshillit të Sigurimit të Rusisë, Dmitry Medvedev është fokusuar në përhapjen e narrativave të tilla si: NATO-ja përbën kërcënim për Rusinë, sanksionet e BE-së dhe ato perëndimore po e detyrojnë Rusinë të reagojë dhe të hakmerret kundër tyre, politikat e NATO-s dhe BE-së po e çojnë botën drejt Luftës së Tretë Botërore. Ndër narrativat e përsëritura dhe që mund të konsiderohet si ndër më të rrezikshmet është ajo e se “Rusia duhet të përpiqet të zhdukë Ukrainën dhe NATO-n”.

Kjo narrativë e artikuluar nga Medvedev ka gjetur shpërndarje edhe në mediat shqiptare gjatë vitit 2023 dhe 2024, pikërisht në prag të samitit të NATO-s. Burimet fillestare që përcjellin narrativa të tilla janë mediat kryesore shtetërore ruse (Tass, Ria Novosti, etj), por edhe media të shteteve të tjera si ‘Skynews’ në Mbretërinë e Bashkuar.

Si një figure kyçe në politikën ruse dhe mbështetës i politikës së presidentit Putin dhe frymës anti-Perëndim, Dmitry Medvedev rezulton si përhapës i këtyre narrativave në të paktën 39 artikuj të shpërndarë në mediat shqiptare gjatë periudhës monitoruese 1 vjeçare.

Vyacheslav Volodin: Kryetar i Dumës Shtetërore të Rusisë. Volodin është i njohur për retorikën e tij kundër NATO-s dhe BE-së dhe ka qenë një mbështetës i fortë i politikave të Kremlinit për dezinformimin. Këto narrativa janë përhapur në mediat shqiptare përmes gati 30 artikujve që citojnë Volodin si akuzues të BE-së dhe Perëndimit se “po vjedh asetet ruse për të militarizuar Kievin”. Mediat shqiptare kanë përhapur edhe narrativën e artikuluar prej

²⁸ Gokhale, N. (2023, 14 korrik). NATO dilemma [Dilema e NATO-s]. “The Statesman”. <https://www.thestatesman.com/opinion/nato-dilemma-1503322193.html>

Volodyn se Rusia do të kundërpërgjigjet duke bllokuar dhe konfiskuar asetet e vende jo-miqësore, duke shënjestruar BE-në në rast se asetet e bllokuara ruse do të përdoren për Ukrainën.²⁹

Volodin është po ashtu ndër përhapësit kryesorë të narrativës anti-BE se blloku po shkel lirinë e shtypit me bllokimin e transmetimit të mediave ruse në territorin e unionit, duke e etiketuar BE-në si hipokrite dhe shkatërruese të vlerave të familjes tradicionale, përmes propagandimit dhe mbështetjes së “industrisë transgjinore”.

Donald Trump: Ish-president i Shteteve të Bashkuara (2017-2021) dhe kandidati republikan për zgjedhjet presidenciale 2024. Trump, si gjatë mandatit të tij të kaluar ashtu edhe në vijim, veçanërisht në takimet elektorale, shpesh kritikon NATO-n dhe BE-në, duke përdorur retorikë që përforcon narrativat e përhapura nga Rusia dhe entitete të tjera kundërshtarë, si për shembull aktorë të së djathtës ekstreme. Një prej këtyre narrativave është ajo se SHBA-ja nuk do t'i mbrojë aleatët e NATO-s që nuk paguajnë nëse ato do të sulmoheshin ose që Trump do të nxiste Rusinë të sulmonte vende anëtare të NATO-s që nuk paguajnë. Këto narrativa dezinformuese, pjesë e retorikës së përsëritur nga Trump sidomos në fushatën presidenciale, janë të ngjashme me ato të shpërndara nga Rusia dhe aktorë kundërshtarë. Të tjera narrativa të Trump janë edhe kundërshtimi i ndihmës ushtarake të Ukrainës, apo narrativa se NATO-ja dhe BE-ja kanë vdekur.³⁰

Nga analiza e të dhënave rezulton se, gjatë periudhës 1-vjeçare, në median shqiptare kanë qarkulluar të paktën 22 artikuj me narrativa kundër NATO-s dhe BE-së-së të cilat citojnë ish-presidentin e SHBA-së Donald Trump.

²⁹ I lasiello, E. (2021). Strategic messaging, propaganda, and the digital information age [Mesazhet strategjike, propaganda dhe epoka dixhitale e informacionit]. In “Russia’s global reach: Security and statecraft assessment” [Arritja globale e Rusisë: Vlerësimi i sigorisë dhe shtetësisë] (Chap. 15). “George C. Marshall European Center for Security Studies”. <https://www.marshallcenter.org/en/publications/marshall-center-books/russias-global-reach-security-and-statecraft-assessment/chapter-15-strategic-messaging-propaganda-and>

³⁰ European Parliamentary Research Service. (2021, February). Disinformation campaigns and COVID-19 [Fushatat e dezinformimit dhe COVID-19]. “European Parliament”. [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2021/679076/EPRS_BRI\(2021\)679076_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2021/679076/EPRS_BRI(2021)679076_EN.pdf)

Peter Szijjarto: Ministër i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Hungarisë. Szijjarto ka qenë një mbështetës i politikave të kryeministrit Viktor Orban dhe shpesh ka kritikuar BE-në, duke përhapur narrativa që minojnë besimin në institucionet evropiane.³¹ Në një numër prej 22 artikujsh që kanë qarkulluar në median shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare që kemi marrë në studim, kryediplomati i Hungarisë artikulon narrativa të tilla si: Misioni i NATO-s për ndihmë afatgjatë ndaj Ukrainës është një mision i çmendur, Kërcënimi me vendosjen e vetos ndaj Bullgarisë, e cila taksoi kalimin e gazit rus, Kievi është i papërshtatshëm për t'u anëtarësuar në BE dhe se ky anëtarësim kërcënon unionin. Të gjitha këto narrative përkujnë me evente kyçe sa i takon luftës në Ukrainë dhe përpjekjeve të Perëndimit për ta ndihmuar, si për shembull në prag të samitit të mbajtur në Zvicër për paqen në Ukrainë, vendosjen e paketës së sanksioneve ndaj Rusisë, pas luftës në Ukrainë, etj.

Baba Vanga: E ashtuquajtur profete, nga Bullgaria dhe e njohur për parashikimet e saj. Edhe pse në mungesë të provave bindëse, pasi këto “profeci” transmetohen nga burime jo të besueshme, parashikimet e Baba Vangës (alias Vangelova Pandeva Gushtenova) kanë gjetur hapësirë në mediat apo platformat sociale në formën e teorive konspirative që parashikojnë profeci që shtrihen (bazuar në narrativat e të përhapura) deri në vitin 5079. Narrativat që serviren për qëllim shtrembërimin e perceptimit të opinionit lidhen me katastrofa natyrore, akte terroriste, atentate ndaj udhëheqësve si rasti i Vladimir Putinit etj. Faktet që i bëjnë edhe më të paqena të ashtuquajturat profeci të Baba Vangës lidhen me mungesën e arsimimit të gruas së lindur në vitin 1911 dhe verbërimin e saj në moshën 12 vjeçare.³²

Megjithëse një figurë jo politike, parashikimet e Baba Vangës shpesh përdoren nga mediat konspirative dhe dezinformuese për të përforcuar narrativa të caktuara edhe kundër NATO-s dhe BE-së. Gjatë studimit janë identifikuar të paktën 12 artikuj të shpërndarë në mediat shqiptare të cilat citojnë median ruse si burim parësor në

³¹ European Parliamentary Research Service. (2021, February). Disinformation campaigns and COVID-19 [Fushatat e dezinformimit dhe COVID-19]. “European Parliament”. [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2021/679076/EPRS_BRI\(2021\)679076_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2021/679076/EPRS_BRI(2021)679076_EN.pdf)

³² Global Disinformation Index. (2023, 4 prill). The Vanga files [Dosjet e Vangës]. “Global Disinformation Index”. <https://gdil.org/the-vanga-files/>

lidhje me profecitë e Baba Vangës.

Perspektiva e mediave mbi narrativat dezinformuese ndaj NATO-s dhe BE-së

Liria e mediave dhe liria e shprehjes në Shqipëri është e garantuar nga Kushtetuta. Neni 22 i Kushtetutës garanton lirinë e shprehjes, të shtypit, radios dhe televizionit, si dhe ndalon censurën paraprake të mjeteve të komunikimit. Si vend anëtar i Këshillit të Evropës, Shqipëria është subjekt i një morie traktatesh ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila garanton gjithashtu lirinë e shprehjes dhe të medias. Liria e shprehjes dhe liria e mediave është e sanksionuar gjithashtu në principet e ligjit “Për median audiovizive”. Megjithëse korniza ligjore e garanton lirinë e shprehjes dhe të medias, kjo e fundit jo gjithmonë zbatohet në praktikë.

Situata e medias në Shqipëri është sfiduese për gazetarët e pavarur dhe mediat, me një peizazh mediatik që karakterizohet nga mungesa e transparencës, presionet politike dhe ekonomike, çfarë i shtyn shumë gazetarë drejt vetcensurës. Pavarësisht zhvillimeve në dekadat e fundit, Shqipëria vazhdon të përballlet me probleme lidhur me pavarësinë e medias dhe mbrojtjen e gazetarisë së lirë.

Në këtë kontekst, dezinformimi është një problem në rritje. Mungesa e një kornize ligjore specifike për të trajtuar dezinformimin e bën të vështirë identifikimin dhe sanksionimin e përhapësve të informacionit të rremë. Po ashtu, niveli i ulët i edukimit mediatik dhe përdorimi i gjerë i mediave sociale si burim informacioni ka kontribuar në përhapjen e dezinformimit në hapësirën mediatike. Ky fenomen është veçanërisht i rrezikshëm kur përdoret për të manipuluar opinionin publik në çështje të rëndësishme si zgjedhjet, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimi në strukturat euroatlantike.

Aktivitetet e aktorëve të jashtëm, të cilët mund të shfrytëzojnë dobësitë e mediave shqiptare për të përhapur narrativat e tyre, kanë ndikuar gjithashtu në përhapjen e informacioneve të rreme ose përçarëse. Kjo është veçanërisht e dukshme në raportimet për Bashkimin Evropian dhe NATO-n, si dhe partnerët strategjikë të Shqipërisë. Media që kontrollohen nga interesa të caktuara shpesh amplifikojnë narrativat e huaja për interesa komerciale ose ideologjike, duke përhapur qëndrime që janë në kundërshtim me interesat kombëtare.

Edhe pse numri i artikujve me narrativa dezinformuese kundër NATO-s dhe BE nga aktorë kundërshtarë i identifikuar gjatë monitorimit të medias është relativisht i ulët, ai nuk është i papërfillshëm dhe është thelbësore të shqyrtohen pikëpamjet e atyre që janë në frontin e parë të prodhimit dhe shpërndarjes së lajmeve – gazetarët, redaktorët dhe menaxherët e mediave.

Përmes intervistave të thelluara me përfaqësues të mediave kryesore në Shqipëri dhe ekspertë kundër dezinformimit, autorët e këtij studimi nxorën në pah sfidat kryesore me të cilat ata përballen, mekanizmat që përdorin për të përballuar këto sfida dhe ndikimin e narrativave dezinformuese në raportimin e përditshëm të tyre mbi NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

— Fluksi i lartë i lajmeve mbi NATO-n dhe BE-në

Në Shqipëri ka një numër të madh mediash online që publikojnë përmbajtje të ndryshme, përfshirë lajme, analiza dhe opinione. Një pjesë e madhe e portaleve botojnë dhjetëra artikuj çdo ditë. Megjithatë, vetëm një numër i vogël i këtyre mediave ka një strukturë të mirëfilltë editoriale, ndërkohë pjesa më e madhe e informacioni riprodhohet nga media të tjera, rrjetet sociale, televizioni dhe hidhet në internet në formatin “copy- paste”.

Pas fillimit të luftës në Ukrainë në shkurt 2022, mediat shqiptare u përballën me një fluks të madh raportimesh mbi NATO-n dhe BE-në dhe zhvillimet në lidhje me agresion rus ndaj Ukrainës. Kjo periudhë e veçantë solli një intensifikim të mbulimit të lajmeve ndërkombëtare, me theks të veçantë te reagimet e NATO-s dhe BE-së ndaj agresionit rus, por edhe të aktorëve të tjerë kundërshtarë ndaj Perëndimit, si Rusia, Bjellorusia, etj.

Gazetarët dhe redaktorët e intervistuar raportuan një rritje të madhe në numrin e lajmeve të publikuara mbi këto tema, shpesh duke arritur deri në 100 artikuj në ditë gjatë fazave fillestare të luftës. Sipas një redaktori nga një agjenci lajmesh, tani që lufta ka hyrë në një fazë më të qëndrueshme, fluksi i lajmeve është ulur në një mesatare prej 20-25 lajmeve në ditë.

“Numri i artikujve që kemi publikuar në lidhje me NATO-n dhe BE-në gjatë ditëve të para të luftës ishte i

jashtëzakonshëm – ndonjëherë arrinte deri në mbi 100 artikuj në ditë. Fluksi i informacioneve ishte kaq i madh dhe ne duhej të reagonim shumë shpejt për të përpunuar dhe publikuar lajmet.” Gazetar, portal lajmesh

Kjo situatë e vendosi median përballë sfidave të reja, siç ishte përzgjedhja dhe verifikimi i informacioneve në një kohë shumë të shkurtër, për të cilën ajo nuk ishte përgatitur ose i mungonin burimet njerëzore dhe profesionale.

— Burimet e informacionit

Një nga aspektet më të rëndësishme të raportimit të mediave shqiptare mbi NATO-n dhe BE-në është varësia e tyre nga burimet ndërkombëtare të lajmeve. Mediat shqiptare nuk kanë mundësi financiare ose burime njerëzore për të mbuluar në mënyrë të pavarur lajmet mbi krizat dhe konfliktet ndërkombëtare, apo mbi institucione ndërkombëtare si NATO-ja dhe Bashkimi Evropian. Gazetarët dhe redaktorët e intervistuar theksojnë se për temat që lidhen me këto dy institucione, ata mbështeten kryesisht te burime të njohura dhe të besueshme si Reuters, BBC, CNN, The Guardian dhe The New York Times.

“Ne përdorim burimet ndërkombëtare kryesore si Reuters, BBC, dhe CNN për të gjitha lajmet që lidhen me NATO-n dhe BE-në. Këto burime na japin një bazë solide për të siguruar që raportimet tona të jenë të sakta dhe të besueshme.” Redaktor, media online

Megjithatë, media shqiptare nuk është immune ndaj përhapjes së dezinformimit ose të narrativave kundër NATO-s dhe BE, veçanërisht nga burime të dyshimta apo të ndikuara nga aktorë të huaj. Disa gazetarë raportuan se kanë hasur në raste ku media të financuara nga Kremli dhe sanksionuara nga Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja si “Russia Today” dhe agjencia e lajmeve “Tass”, janë përdorur si burime duke përhapur narrativa dezinformuese. Edhe media shtetërore kineze dhe iraniane, si Radio Ejani dhe Pars Today shërbejnë si burim informacioni në disa raste.

Një gazetar përmendi një rast specifik ku një lajm që vinte nga agjencia e lajmeve “TASS” për përdorimin e trupave mercenare izraelite nga Ukraina u kap vetën në moment të fundit nga filtri editorial.

“Po, për këtë kam një episod. Ishte marrë një lajm, një pretendim nga agjencia Tass, gjatë luftës në Ukrainë (maj-qershor 2024) se Zelenksi kishte origjinë hebreje, ka marrë trupa nga Izraeli dhe po i përdor në frontin e luftës. Dhe një pakujdesi, mungesë vëmendje, apo përvoje e një gazetari të ri, gabimisht u angazhua në sistem, nuk arriti të publikohej dhe ishte gati për t’u raportuar si lajm, por u kap menjëherë dhe rezultoi që ishte raportim i TASS.” Drejtues, televizion.

“Dy të parat jo (TASS, Ria Novosti), ndërsa nga RT kemi publikuar vetëm citime të drejtpërdrejta të ministrit të Jashtëm rus ose të presidentit.” Redaktor, televizion

— Mungesa e njohurive të specializuara mbi NATO-n dhe BE-në

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen gazetarët dhe redaktorët shqiptarë është mungesa e njohurive të thelluara mbi rolin dhe funksionimin e NATO-s dhe BE-së. Kjo shpesh rezulton në raportime që mund të mos japin një pasqyrë të plotë ose të saktë të zhvillimeve ndërkombëtare.

“Një gazetar që mbulon NATO-n ose BE-në duhet të ketë njohuri të thelluara mbi mënyrën se si këto institucione funksionojnë. Shpesh nuk mjafton thjesht një përkthim i informacionit nga mediat ndërkombëtare; ka raste kur nevojitet interpretim më i thellë dhe një i kuptuar më i mirë i kontekstit.” Redaktor, media online

Në këtë kuptim, gazetarët theksojnë se mungesa e trajnimeve të specializuara dhe e burimeve të mjaftueshme për të ndjekur ngjarje ndërkombëtare i vendos ata në një dizavantazh të madh krahasuar me kolegët e tyre në media të vendeve më të zhvilluara. Kjo gjë bën që media shqiptare të mbështetet kryesisht në informacionet e transmetuara nga burime të huaja dhe të ketë më pak mundësi për raportime të pavarura ose hulumtuese mbi këto tema.

“Më parë, në redaksinë time ka pasur një gazetar të dedikuar për botën. Vitin e fundit nuk ka një të tillë, ndaj them që edhe unë kam bërë lajme për Ukrainën që dikur nuk i bëja. Dhe meqë nuk ka më një gazetar nga bota, gazetarë të tjerë që mund ta kenë ditën më të lirë kur ka një ngjarje apo një lajm që lidhet me këto tema, mund të merren edhe me këto zhvillime.” Gazetar, televizion.

— Mungesa e politikave editoriale dhe korrigjimi i lajmeve të reme

Gazetarët dhe redaktorët e intervistuar mohuan çdo presion për të publikuar artikuj të caktuar për NATO-n dhe BE-në. Sipas tyre, tematika e luftës në Ukrainë dhe çështjet ndërlidhëse, përfshirë NATO-n dhe BE-në, është tërheqëse për audiencën, veçanërisht kur përfshihen foto dhe video. Lufta, si një temë e ndjeshme, gjithmonë ka interes dhe titujt shpesh janë të zgjedhur për të pasqyruar ndodhitë më dramatike, si shpërthime apo deklarata zyrtare.

Sipas të intervistuarve, publiku shqiptar është i interesuar të informohet për luftën në Ukrainë për shkak të afërsisë gjeografike dhe ndjeshmërisë që kjo sjell. Lufta në Ukrainë shihet jo vetëm si një konflikt i largët, por edhe si një përplasje mes Lindjes dhe Perëndimit që ndikon rajonin e Ballkanit. Gjithashtu, raportimi mbi NATO-n dhe BE-në tërheq një audiencë më të kualifikuar, sidomos kur bëhet fjalë për vendimmarrje në aleancat ndërkombëtare.

Ndikimi i luftës në Ukrainë dhe zhvillimet gjeopolitike janë gjithashtu të rëndësishme për audiencën shqiptare, veçanërisht për ata që kanë lidhje me shqiptarët që jetojnë në rajone të tjera si Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Rajoni i Ballkanit, me një histori konfliktesh, është veçanërisht i ndjeshëm ndaj zhvillimeve në Evropën Lindore dhe audienca tregon interes për këtë ndikim në stabilitetin e rajonit dhe marrëdhëniet me BE-në.

Përmbajtja lidhur me luftën dhe NATO-n tërheq një interes të madh për shkak të dhunës dhe pasojave që mund të ketë për sigurinë dhe ekonominë. Shqiptarët janë të lidhur ngushtë me NATO-n dhe BE-në dhe çdo zhvillim në këto institucione është me interes të madh për publikun, sidomos në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare që ndikojnë në Shqipëri dhe rajon.

Megjithatë, shumica e të intervistuarve pohojnë se nuk ndjekin një politikë editoriale të veçantë për lajmet mbi luftën në Ukrainë, NATO-n dhe BE-në, por mbështeten në parimet gazetareske dhe interesin e publikut.

Shumë redaksi deklaruan se ndjekin praktika të qarta për verifikimin, duke kërkuar të paktën dy burime për çdo informacion dhe, në raste të veçanta, presin konfirmime nga më shumë burime. Për shembull, një lajm i rëndësishëm, si ai mbi ofensivën ukrainase në Rusi, ishte subjekt i hezitimit derisa u konfirmua nga disa burime kryesore dhe

postimi i presidentit Zelensky. Disa gazetarë shpjegojnë se në mungesë të kontakteve direkte me terrenin, ata mbështeten në mediat më të besueshme ndërkombëtare. Megjithatë, nëse një lajm është raportuar vetëm nga një media, shpeshherë vendoset që të mos publikohet derisa të ketë mbështetje nga burime të tjera kryesore.

Shumica e portaleve me të cilët u kontaktua kanë pranuar se janë përballur me raste të publikimit të lajmeve dezinformuese, të cilat janë korrigjuar ose fshirë nga faqet dhe mediat sociale. Kryeredaktorë dhe menaxherë të ndryshëm pohojnë se në raste gabimesh, lajmet korrigjohen ose fshihen, por rrallëherë përgënjeshtrohen me një postim të ri në mediat sociale. Këto gabime, sipas tyre, mund të ndodhin edhe për shkak të keqinformimeve nga burime të tjera, përfshirë agjencitë ndërkombëtare, dhe shpesh janë rezultat i mungesës së përvojës të gazetarëve të rinj. Megjithatë, redaktorët theksojnë se ekzistojnë mekanizma të brendshëm për të filtruar dhe verifikuar informacionin përpara publikimit, me qëllim që të shmangen lajmet e rreme.

— Kërcënimi nga narrativat dezinformuese

Nga këndvështrimi i gazetarëve dhe ekspertëve të intervistuar, është e qartë se dezinformimi anti-NATO dhe anti-BE nuk përbën ende një kërcënim të drejtpërdrejtë për politikën apo stabilitetin në Shqipëri, por mbetet një fenomen që duhet monitoruar.

Ata pranuan se këto narrativa shpesh mbeten në periferi dhe nuk kanë ndikimin e dëshiruar në opinionin publik. Sidoqoftë, ekspertët theksuan se është thelbësore të ndërmerren hapa për të parandaluar përhapjen e tyre në një kohë kur teknologjitë digjitale dhe rrjetet sociale po e bëjnë gjithnjë e më të lehtë shpërndarjen e lajmeve të rreme dhe narrativave nga aktorë kundërshtarë. Ekspertët theksojnë nevojën për krijimin e një kornize të fortë ligjore për të trajtuar kërcënimet e dezinformimit në nivel digjital.

“Edukimi për median dhe informacionin duhet të përfshihet në kurrikulat shkollore, duke ndihmuar brezin e ri dhe grupmoshat më të vjetra të dallojnë mes lajmeve të sakta dhe dezinformatave.” Eksperte e të drejtave digjitale.

Përfaqësuesit e mediave që u intervistuan pohuan se e kanë kufizuar marrjen e lajmeve nga agjencitë ruse të

lajmeve si TASS, Ria Novosti dhe Russia Today (RT), duke iu referuar atyre vetëm kur bëhet fjalë për qëndrimet zyrtare të qeverisë ruse. Kryeredaktorët dhe drejtuesit e portaleve shpjeguan se i përdorin burimet ruse vetëm për qëndrime të verifikuara dhe të qarta të Kremlinit, duke cituar me kujdes burimin origjinal për të shmangur shpërndarjen e dezinformatave.

Në disa raste, përfaqësuesit e disa mediave kanë përshkruar politika të brendshme redaksionale që kufizojnë përdorimin e këtyre burimeve, sidomos pas vendosjes së sanksioneve nga BE-ja dhe SHBA-ja ndaj mediave ruse. Nëse nuk ka një komunikatë të qartë zyrtare me burime të verifikuara nga burimet perëndimore, informacioni nuk publikohet. Kjo qasje tregon angazhimin e tyre për të ruajtur standardet profesionale në raportimin e informacioneve nga Rusia.

Në lidhje me dy mediat iraniane dhe kineze, si Pars Today dhe Radio Ejani, shumica e mediave shqiptare shprehen se nuk i përdorin si burime informacioni. Vetëm një gazetë pranoi se mund të ketë ndodhur në raste të rralla të ketë marrë informacione nga këto media, ndërsa të tjerët nuk i konsiderojnë burime të besueshme. Portalet kryesore theksojnë se nuk kanë publikuar lajme nga këto burime, ndërsa disa prej tyre as nuk janë të njohura nga stafi redaksional.

Radio Ejani, në veçanti, konsiderohet nga disa gazetarë si një mjet propagandistik i qeverisë kineze, që synon të përhapë mesazhe anti-perëndimore në Shqipëri. Përfaqësuesit e disa mediave shprehën shqetësime për ndikimin e saj, duke e cilësuar si një rrezik potencial për mjedisin informativ shqiptar për shkak të cilësisë së lartë dhe investimeve të mëdha në përmbajtje.

Në përgjithësi, përfaqësuesit e mediave shqiptare janë të kujdesshëm në marrjen e informacioneve nga agjencitë e huaja, veçanërisht nga ato që lidhen me shtetet autoritare, duke u përpjekur të ruajnë pavarësinë redaksionale dhe duke zbatuar filtra të rrepta për verifikimin e burimeve të informacionit.

— Përhapja e narrativave dezinformuese

Dy eksperte të shoqërisë civile të intervistuar vlerësojnë se narrativat dezinformuese anti-NATO dhe anti-BE nuk kanë arritur përmasa shqetësuese në Shqipëri. Sipas tyre, dezinformimi i brendshëm, i nxitur kryesisht nga politikanët shqiptarë, është një problem më i madh dhe më i përhapur.

Njëra prej ekspertëve pohoi se politikanët kryesorë në Shqipëri, si Edi Rama, Sali Berisha dhe kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, janë përgjegjës për përhapjen e dezinformimit, pasi media shpesh riposton materialet e tyre pa verifikim, duke bërë që narrativat e tyre të përhapen pa kontroll. Ekspertja theksoi se media shqiptare veprojnë si megafona për politikanët dhe rrallëherë ofrojnë raportim të pavarur. Kjo krijon një atmosferë ku diskursi anti-BE dhe anti-NATO mund të dominojë, në varësi të narrativës që përçojnë liderët politikë në vend.

Sipas ekspertëve mungesa e trajnimit dhe njohurive për BE-në dhe NATO-n, së bashku me avancimin e teknologjisë digjitale, ndihmojnë në përhapjen e narrativave dezinformuese. Audiencia është e paimunizuar ndaj këtij dezinformimi, duke e bërë më të lehtë përhapjen e tij. Ato vërejnë gjithashtu se edhe talk show-t dhe programet e ndarjes së opinionëve në median audiovizive janë platforma për përhapjen e këtyre narrativave. Këto programe shpesh ftojnë pseudo-ekspertë që portretizojnë Rusinë pozitivisht dhe Perëndimin negativisht, duke i shtyrë këto narrativa në masë, veçanërisht online.

Sipas ekspertëve, pavarësisht përhapjes së dezinformimit, shqiptarët mbeten pro BE-së dhe NATO-s. Ata theksojnë se këto organizata gëzojnë mbështetje të gjerë nga publiku shqiptar. Megjithatë, ekspertët nënvizojnë gjithashtu rëndësinë e studimit dhe trajtimit të narrativave dezinformuese për të parandaluar efektet negative të tyre.

Sipas një eksperteje ukrainase gjetjet e këtij studimi përkohë me narrativat dezinformuese të përhapura kundër NATO-s dhe BE-së që qarkullojnë edhe në Ukrainë. Qëllimi i përbashkët i këtyre narrativave në Shqipëri dhe Ukrainë është minimi i besimit në NATO dhe BE, duke përçarë shoqërinë dhe destabilizuar këto aleanca.

Rekomandime

Nëpërmjet intervistave me gazetarë, redaktorë, drejtues mediash, si dhe ekspertë shqiptarë dhe të huaj kundër dezinformimit, autorët e këtij studimi kanë mbledhur një seri rekomandimesh që kanë për qëllim forcimin luftës kundër narrativave dezinformuese dhe përçarëse të artikuluar nga aktorë të huaj kundërshtarë në median shqiptare, të cilat përmbliohen si më poshtë, të grupuara sipas kategorive që targetojnë:

Ndërhyrje ndërsektoriale

Duhet të krijohen grupe ndërdisiplinore që përfshijnë ekspertë të fushave të ndryshme si media, teknologjia, gjeopolitika dhe shkencat sociale për të kuptuar më mirë narrativat e dezinformimit dhe ndikimin e tyre në shoqëri.

Të ngrihet një grup informal i përbashkët gazetarësh, aktorësh të shoqërisë civile, akademikësh dhe ekspertësh. Ky grup do të lehtësonte shpërndarjen dhe përpunimin e informacionit përmes takimeve periodike, grupeve të komunikimit si WhatsApp dhe workshopeve. Ekspertët do të ndihmojnë në përkthimin e raporteve dhe analizave të ndërlikuara në mënyrë që gazetarët të mund të informohen dhe raportojnë në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.

Duhet të fillojë diskutimi për harmonizimin e kornizës ligjore të Bashkimit Evropian për përgjegjësinë dhe transparencën e platformave digjitale me legjislacionin shqiptar, për të mbrojtur më mirë të drejtat e përdoruesve dhe për të parandaluar abuzimet.

Duhet të ndërtohet një përpjekje gjithëpërfshirëse për të luftuar dezinformimin, duke përfshirë jo vetëm kontrolluesit e fakteve dhe OJQ-të, por edhe organizatat qeveritare. Komunikimi zyrtar duhet të jetë i qartë dhe i thjeshtë, ndërsa përgjigja ndaj lajmeve të rreme të jetë e shpejtë dhe efektive. Ky angazhim i koordinuar është i domosdoshëm për të parandaluar përhapjen e narrativave të rreme në publik.

Në kushtet e një konflikti të madh në kontinent, lufta e informacionit ka një rëndësi kritike. Është e nevojshme që shtetet dhe organizatat të analizojnë burimet kryesore nga të cilat popullata merr informacion, për të identifikuar influencuesit e opinionit publik. Kjo ndihmon në shmangien e depërtimit të mesazheve nga vende të mundshme kundërshtarë, të cilat përdorin median sociale dhe mesazhe nga aktorë të ndryshëm për të përhapur dezinformata.

Organizatat e shoqërisë civile

Organizatat e shoqërisë civile duhet të ndërgjegjësojnë qytetarët për çështjet e dezinformimit, edukimin për median dhe informacionin, si dhe sfidat që vijnë nga teknologjitë moderne si inteligjenca artificiale. Këto organizata mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e aftësive në dallimin e informacionit të saktë nga keqinterpretimet.

Shoqëria civile duhet të raportojë tek institucionet ligjore kur hasen raste të dezinformimit që mund të përbëjnë shkelje të rënda ligjore. Përveç ndërgjegjësisimit, këto organizata duhet të ndihmojnë në fuqizimin e grupeve dhe komuniteteve për të qenë më vigjilentë ndaj dezinformimit.

Organizatat e shoqërisë civile duhet të shohin komunikimin si një mjet strategjik për përmirësimin e cilësisë së informacionit që qarkullon, duke promovuar vetëdijen dhe përgjegjësinë për përmbajtjen që shpërndahet.

Nevojitet pajisja e organizatave dhe kërkuesve me mjete teknologjike dhe ekspertizë për të monitoruar dhe identifikuar narrativat e dezinformimit në mënyrë sistematike. Kërkuesit dhe shoqëria civile duhet të trajnohen për të përdorur këto mjete në mënyrë efektive.

Organizatat e shoqërisë civile duhet të ndjekin një qasje më konsistente për monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në hapësirën kibernetike dhe për ekspozimin e dezinformatave, duke bashkëpunuar ngushtë me politikëbërësit dhe ekspertët ndërkombëtarë për përmirësimin e kornizave ligjore dhe rregullatore.

Mediat dhe platformat digjitale

Mediat duhet të implementojnë filtra më të fortë editoriale për të shmangur përhapjen e dezinformatave nga burime të pasigurta ose tabloide. Kjo mund të ndihmojë në uljen e ndikimit të dezinformimit të pvetëdijshëm që shpesh përhapet për arsye komerciale, si kërkesa për më shumë klikime.

Për të përmirësuar raportimin etik dhe verifikimin e fakteve, është e nevojshme të forcohen kapacitetet e gazetarëve dhe redaksive për të trajtuar çështje të ndjeshme dhe të promovojnë vetërregullimin si një mekanizëm për të shmangur censurën.

Platformat digjitale duhet të jenë transparente në lidhje me algoritmet dhe sistemet e tyre të brendshme për mënyrën si shpërndahet informacioni. Ato duhet të ofrojnë sisteme efektive raportimi dhe të investojnë në staf që të njohë kontekstet lokale për të trajtuar më mirë përmbajtjen problematike.

Edukimi mediatic dhe digjital


Edukimi për median dhe informacionin duhet të përfshihet në kurrikulat shkollore. Përveç nxënësve të rinj, duhet fokusuar edhe tek grupmoshat mbi 50 vjeç, të cilët kanë më shumë nevojë për një edukim më të thellë për të përballuar sfidat e dezinformimit në epokën digjitale.

Edukimi digjital dhe mediatic është kyç për të mbrojtur qytetarët nga kërcënimet e sigurisë digjitale dhe për të zhvilluar një konsum kritik të informacionit. Gjithashtu, edukimi ligjor duhet shtuar si pjesë integrale e trajnimeve mbi edukimin digjital dhe mediatic, si element i rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave digjitale.

Duhet të rritet përhapja e verifikimeve të fakteve dhe përgënjeshtimeve të dezinformatave përmes intervistave me ekspertë dhe kontrollues faktesh. Komunikimi i këtyre përmbajtjeve në një gjuhë të thjeshtë dhe shpërndarja e tyre në rrjetet sociale janë thelbësore. Për më tepër, arsimit parauniversitar dhe universitar duhet të përfshijë mësimet mbi qëllimin dhe rëndësinë e NATO-s dhe BE-së.

Organizimi i trajnimeve specifike dhe seminareve për verifikimin e fakteve, përballjen me lajme të rreme dhe

promovimi i të menduarit kritik duhet të jetë prioritet. Përfshirja e informacionit të saktë mbi NATO-n dhe BE-në në sistemin arsimor ndihmon në fuqizimin e të rinjve dhe qytetarëve për të dalluar informacionin e saktë nga ai i manipuluar.



**SHPËRNDARJA E NARRATIVAVE DEZINFORMUESE
KUNDËR NATO-S DHE BE-SË NGA AKTORË
KUNDËRSHTARË
NË MEDIAN SHQIPTARE**

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (Balkan Investigative Reporting
Network in Albania - BIRN)
Tiranë, 2024